



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

Nr. i Dokumentit: 22.14.1-2018-08

**RAPORTI I AUDITIMIT PËR KOMUNËN E PRIZRENTIT
PËR VITIN FINANCIAR TË PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2018**

Prishtinë, qershor 2019

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Misioni ynë është që përmes auditimeve cilësore të fuqizojmë llogaridhënien në administratën publike për përdorimin efektiv, efikas dhe ekonomik të burimeve kombëtare.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike pasi që ato ofrojnë bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate buxhetore. Në këtë mënyrë, ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Ky auditim është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit si dhe me praktikat e mira evropiane.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Prizrenit, në konsultim me Ndhmës Auditorin e Përgjithshëm *Naser Arllati*, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti është rezultat i auditimit të kryer nga *Kapllan Muhaxheri* Udhëheqës i Ekipit dhe *Fetah Osmani, Fanol Hodolli* dhe *Arian Zenelaj* Anëtarë, nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të Auditimit *Luljeta Morina*.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme	4
1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit.....	6
2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet për raportim të jashtëm	7
3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli.....	11
4 Qeverisja e mirë.....	38
5 Progresi në zbatimin e rekomandimeve.....	42
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA.....	53
Shtojca II: Letër Konfirmimi	56

Përmbledhje e përgjithshme

Ky Raport përmbledhë çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Pasqyrave Financiare Vjetore të Komunës së Prizrenit për vitin 2018, i cili përfshin Opinionin e Auditorit të Përgjithshëm për Pasqyrat Financiare Vjetore. Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2018 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e aplikuar e auditimit është paraqitur në Planine Jashtëm të Auditimit, të datës 02/11/2018.

Auditimi ynë është fokusuar në:



Niveli i angazhimit për të kryer auditimin është përcaktuar varësisht nga cilësia e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti i komunës.

Opinion i Auditorit të Përgjithshëm

Opinion i pamodifikuar me theksim të çështjës

Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin 2018 *paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë* në të gjitha aspektet materiale.

Theksim i Çështjës


Ne tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se shpenzimet në vlerë 1,047,427€ ishin keq klasifikuar, prej të cilave 923,878€ ishin buxhetuar dhe aprovuara me ligjin e buxhetit.

Gjithashtu, edhe shpalosjet e llogarive të arkëtueshme për tatimin në pronë ishin mbivlerësuar për 214,234€ dhe obligimet e papaguara ishin nënvlerësuar për 904,746€. Si dhe informatat e shpalosura për pasuri në pasqyrat financiare nuk ishin të plota dhe të sakta.

Më gjerësisht shih Pjesën 2.1 të këtij Raporti.

Shtojca I, shpjegon llojet e opinionëve, sipas SNISA-ve.

Konkluzionet dhe rekomandimet kryesore



Përgjigja e menaxhmentit në auditimin 2018

Kryetari është pajtuar me gjetjet dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do t'i adresoj të gjitha rekomandimet e dhëna.

Zyra Kombëtare e Auditimit vlerëson bashkëpunimin e menaxhmentit dhe personelit të Komunës, gjatë procesit të auditimit.

1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

Auditimi përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave tjera financiare, me sa vijon:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Nëse funksionet e kontrollit dhe të auditimit të brendshëm janë të përshtatshme dhe efikase.
- Nëse janë ndërmarrë veprimet e duhura për zbatimin e rekomandimeve të auditimit.

Puna e ndërmarrë e auditimit është bazuar në vlerësimin e rrezikut. Ne kemi analizuar veprimtarinë e Komunës së Prizrenit, nivelin e mbështetjes në kontrollet menaxheriale për të përcaktuar nivelin e testeve të hollësishme, që janë të nevojshme për të siguruar dëshmitë dhe që e mbështesin opinionin e AP-së.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në masën që ne i konsiderojmë të nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen si një pasqyrë gjithëpërfshirëse e të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo e të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

Kapitujt në vijim ofrojnë përmbledhje të detajuar të gjetjeve tona të auditimit dhe rekomandimet në çdo fushë të rishikimit. Përgjigjet e menaxhmentit në rezultatet e auditimit mund të gjenden në Shtojcën II.

2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet për raportim të jashtëm

Auditimi i Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese dhe cilësinë e saktësinë e informacionit të prezantuar në PFV, përfshirë deklaratën e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar.

Deklarata për prezantimin e PFV-ve përfshinë një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PFV-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante u janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një proces auditimi.

2.1 Opinioni i auditimit

Opinion i Pamodifikuar me theksim të çështjes

Ne kemi audituar PFV-të e Komunës së Prizrenit për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme, pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, shpalosjet dhe raportet tjera përcjellëse.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (të kontabilitetit në para të gatshme), Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë -LMFPP (i ndryshuar me Ligjin nr.03/L-221, Ligjin nr. 04/L-116 dhe Ligjin nr. 04/L-194) dhe Rregulloren MF, Nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore.

Baza për opinion

Ne kemi kryer auditim në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Theksimi i çështjes

Ne tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se:

- Shpenzimet për mallra e shërbime, paga e mëditje si dhe subvencione në vlerë 965,864€, ishin buxhetuar realizuar dhe raportuar gabimisht nga kategoria e investimeve kapitale. Nga kjo vlerë, pagesat prej 923,878€ ishin të buxhetuar dhe miratuar me ligjin e buxhetit. Këto mjete ishin shpenzuar kryesisht për kontratat: Fshirja dhe larja e rrugëve; Furnizimi i fermerëve me farë gruri dhe misri; Sigurimi fizik i objektit; Subvencionimi i klubeve sportive; Manifestimet e festave të Qershorit etj. Sipas

komunës shkak i një keq klasifikimi të tillë ishte mungesa e buxhetit në kategoritë përkatëse edhe pse për shumicën e shpenzimeve ishte bërë aprovimi i buxhetit nga ana e thesarit mirëpo kodet e projekteve ishin keq klasifikuar. Po ashtu përmes vendimeve gjyqësore, dhe pagesa direkte nga thesari sipas nenit 39.2 të LMFPJ janë paguar shpenzimet për paga jubilarë të mësimdhënësve në vlerë 123,549€, nga kategoria e investimeve kapitale 41,986€ dhe nga kategoria e mallrave e shërbimeve 81,563€. Këto pagesa janë bërë duke shfrytëzuar mjetet e lira pa marr parasysh natyrën dhe klasifikimin e drejt të shpenzimit. Pavarësisht arsyetimeve të prezantuara, sipas standardeve të kontabilitetit të sektorit publik këto shpenzime nuk plotësojnë kriteret për tu trajtuar si kapitale;

- Komuna nuk ka harmonizuar saldot përfundimtare të kartelës së llogarive të arkëtueshme për tatimin në pronë me saldote fillestare, duke mbivlerësuar në PFV këto llogari për 214,234€¹. Komuna nuk ka arritur të na ofroj dëshmi për të arsyetuar diferencën e paraqitur;
- Obligimet e vitit 2017 në vlerë 792,045€, vetëm nga kategoria e investimeve kapitale në vlerë prej 773,114€ dhe 18,931€ nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve të paguara gjatë vitit 2018, nuk ishin shpalosur si obligime të papaguara sipas kërkesave të neni 17² në PFV të vitit 2017. Po ashtu obligimet e vitit 2018 në vlerë prej 112,691€ nuk ishin prezantuar dhe shpalosur si obligime të papaguara të neni 17³ dhe janë paguar në fillimin e vitit 2019, andaj edhe saldo e llogarive të pagueshme për vitin 2018 ishte e nënvlerësuar për 904,746€; dhe
- Pasuritë jo-financiare me vlerë mbi 1,000€ të shpalosura në PFV, nuk përfshinë pagesën për blerjen e automjetet nga investime kapitale gjatë vitit 2018, në vlerë 75,707€⁴. Opinioni jonë nuk është i modifikuar për këto çështje.
-

Çështjet kyçe të auditimit

Si çështje kyçe të auditimit përmendim faktin se:

¹ Saldo e vitit 2017 ishte në vlerë prej =7,238,000€, faturimi për vitin 2018 ishte+ 2,833,078€, arkëtimet e vitit 2018 ishin në vlerë prej -2,196,722€ saldo duhet të jetë në vlerë prej =7,874,356€, ndërsa ishin prezantuar në vlerë prej 8,089,120€, pra kemi një mbivlerësim prej +214,764€.

² ("Pasqyra e detyrimeve (faturat) e papaguara nga mostrat e testuar /baza e furnitorëve").

³ (Pasqyra e detyrimeve (faturat)te aneksi 1-faturat e pa paguara, nuk ishin të plota sepse faturat në këtë vlerë nuk ishin prezantuar dhe janë paguar në fillimin për vitin 2019.

⁴ Pagesa e ekzekutuar në 2018, blerja e automjetit për drejtorin e mërqinjës sociale me Nr- 017/2016 e datës 29.12.2016.

- Komuna e Prizrenit ka prezantuar gjendjen e llogarive të arkëtueshme (LLA) prej 18,932,000€. Në këtë shumë përfshihen të arkëtueshme të vjetërsuara prej shumëvitesh të taksat në firmë në vlerë prej 6,818,000€, ku mundësia e arkëtimit të tyre është minimale. Po ashtu mbi 58% të kësaj llogarie të prezantuar në PFV, e përbejnë të arkëtueshmet nga mbeturinat dhe tatimi në pronë;
- Gjatë vitit 2018 komuna është paditur për shuma të konsiderueshme të obligimeve, ku 2.5 mil.€ janë kryer pagesa direkt nga thesari dhe përmes vendimeve gjyqësore; dhe
- Komuna ka një rritje në vazhdimësi të detyrimeve kontingjente. Për më tepër afro 3,880 lëndë janë në procese të procedurave gjyqësore, vlera e tyre ka arritur shumën prej 4,130,000€, me një rritje prej 2,907,000€ në raport me vitin e kaluar. Nëse paditë gjyqësore vendosen në favor të operatorëve, organizata pritet të ketë pasoja të rënda financiare.

Përgjegjësia e menaxhmentit për PFV

Kryetari i Komunës së Prizrenit është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme të modifikuar, dhe për kontrollet e brendshme të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare, pa keq-deklarime materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime).

Kryetari i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV në bazë të auditimit të kryer. Auditimi është kryer në përputhje me SNISA. Këto standarde kërkojnë që t'i përmbahemi kërkesave të SNISA-ve, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim i kryer në pajtim me SNISA-t do të zbuloj çdo keq-deklarim material që mund të ekzistoj. Keq-deklarimet mund të rezultojnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keq-deklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që

të dizajnoj procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përlllogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

2.2 Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim

Komuna kërkohet të raportoj në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregulloren MF. Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiare nga Organizatat Buxhetore;
- Kërkesat e LMFP-së nr. 03/L-048, i ndryshuar me Ligjin nr.03/L-221, Ligjin nr.04/L-116 dhe Ligjin nr. 04/L-194;
- Pajtueshmërinë me Rregullat Financiare- nr. 01/2013 /MF - Shpenzimi i parave publike dhe 02/2013- Menaxhimi i pasurisë jo financiare në OB;
- Ligji për financat e pushtetit lokal Nr. 05/L -108 dhe plotësim ndryshimi Nr. 03/L-049;
- Kërkesat e ligjit të buxhetit për vitin 2018;
- Kërkesat e Procedurave të Menaxhimit Financiar dhe të Kontrolleve (MFK);
- Kërkesat tjera për raportime buxhetore, siç janë raportet mujore dhe tremujore, raportet operative (të performancës);
- Raportimet tremujore për Kuvendin Komunal dhe diskutimi i raporteve të ZKA-së nga KK;
- Planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve; dhe
- Planin e prokurimit dhe raportin e kontratave të nënshkruara publike.

Në PFV-të e dorëzuara në muajin janar 2019 ishin prezantuar disa gabime, të cilat menaxhmenti i kishte përmirësuar dhe korrigjuar. Më gjithë përmirësimet e bëra PFV-të ende kishin disa gabime, kryesisht keq-klasifikimet i shpenzimeve, si dhe shpalosjet e pasurisë, të arkëtushmeve dhe obligimeve të cilat i kemi prezantuar tek theksimi i çështjes te opinionit auditimit.

Marrë parasysh çka u tha më lartë, Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, me rastin e dorëzimit të PFV-ve në Ministrinë e Financave, mund të konsiderohet e saktë përveç çështjeve që i kemi theksuar te opinionit i auditorit.

Në këtë kontest të raportimit të jashtëm kemi vërejtur se komuna ka plotësuar kënaqshëm të gjitha kërkesat për raportim përveç raportimit të plotë/saktë mujor të obligimeve në MF, sipas Rregullës financiare 02/2013.

2.3 Rekomandimet lidhur me Pasqyrat Financiare Vjetore

Rekomandimi C1 Kryetari duhet të sigurojë që është bërë një analizë për të përcaktuar arsyet për theksim të çështjes. Duhet të ndërmerren veprime për të adresuar dobësitë në regjistrimin dhe prezantimin e drejt të shpenzimeve dhe eliminuar dobësitë në shpalosjen e plot të pasurisë, obligimeve dhe llogarive të arkëtueshme të prezantuara si theksimi i çështjes te opinioni i auditimit.

Gjithashtu, kryetari duhet të siguroj se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që plani i hartimit të PFV 2019 i adreson të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me pajtueshmërinë. Kjo gjithashtu duhet të përfshijë rishikimin e draft PFV-ve nga menaxhmenti, me fokus të veçantë në fushat me rrezik të lartë dhe/ose fushat ku janë identifikuar gabime në vitet e mëparshme. Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, nuk duhet të dorëzohet përveç nëse ndaj draft PFV-të janë aplikuar të gjitha kontrollet e nevojshme.

3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Puna jonë lidhur me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK), pasqyron aktivitetet e detajuara të auditimit për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në organizatat buxhetore. Në mënyrë të veçantë, në fokus të auditimit ishte menaxhimi i buxhetit, çështjet e prokurimit, burimet njerëzore si dhe pasuritë dhe detyrimet.

Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

Sa i përket menaxhimit financiar dhe zbatimit të kontrolleve, mos realizimi i projekteve kapitale sipas buxhetit, dhe vonesat në pagesa e obligimeve (pagesat direkt nga Thesari) mbeten sfidat më të theksuara që përballen komuna. Në kontekst të sistemeve financiare, kontrollet mbi të hyrat në përgjithësi si dhe kontrollet në disa fusha të shpenzimeve, kërkojnë përmirësim të mëtejshëm për të parandaluar ekzekutimin e pagesave përmes vendimeve gjyqësore. Fushat kryesore ku nevojiten më shumë përmirësime janë realizimi i buxhetit tek projektet kapitale, menaxhimi i llogarive të arkëtueshme, keq klasifikimi i shpenzimeve kontratat për shërbimet e veçanta dhe tjera.

3.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore dhe shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final ⁵	2018 Realizim	2017 Realizimi	2016 Realizimi
Burimet e Fondeve:	45,090,516	48,570,932	41,749,765	36,765,293	36,983,514
Granti i Qeverisë -Buxheti	36,470,071	36,134,711	33,736,653	30,869,927	30,767,839
Të bartura nga viti paraprak ⁶	0	3,229,709	2,996,203	1,573,645	1,345,624
Të hyrat vetjake ⁷	8,121,284	8,121,284	4,687,469	4,125,517	4,679,230
Donacionet e brendshme	0	310,212	56,121	83,697	84,038
Donacionet e jashtme	0	251,607	117,311	14,150	106,783
Huamarrjas	499,161	523,409	156,008	98,357	-

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 3,480,416€. Kjo rritje është rezultat i kursimeve nga granti qeveritar në bazë të vendimit të qeverisë, për 335,360€, bartjes së të hyrave nga viti paraprak 3,229,709€, rritjes së fondeve nga huamarrja 24,248€ dhe përfitimi i fondeve nga donatorët e brendshme 310,212€ dhe të jashtëm për 251,607€.

Në vitin 2018, komuna ka shpenzuar vetëm rreth 86 % të buxhetit final, me një performancë me të ultë se sa realizimi krahasuar më vitin 2017 (91 %), realizimi i buxhetit mbetet në nivel jo të kënaqshëm dhe më poshtë jepen shpjegimet për pozitën aktuale.

Tabela 2: Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2018 Realizimi	2017 Realizimi	2016 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	45,090,516	48,570,932	41,749,765	36,765,293	36,983,514
Pagat dhe Mëditjet	19,956,411	19,745,113	19,495,068	18,777,598	18,919,546
Mallrat dhe Shërbimet	5,761,619	6,252,553	5,609,365	2,670,957	2,807,989
Shërbimet komunale	1,081,200	1,244,975	763,464	869,094	762,688

⁵ Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave.

⁶ Të hyrat vetjake të pashpenzuara të komunës në vitin paraprak dhe të bartura në vitin aktual.

⁷ Pranimet e përdorura nga entiteti për financimin e buxhetit të vet.

⁸ Huamarrja nga banka botërore (për drejtorit e Shëndetësisë dhe Arsim).

Subvencionet dhe Transferet	477,615	548,459	539,906	463,438	325,767
Investimet Kapitale	17,813,671	20,779,832	15,341,962	13,984,206	14,167,524

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore janë dhënë si në vijim;

- Pavarësisht rritjes prej 2,986,161€ të buxhetit final krahasuar me buxhetin fillestar për investime kapitale vetëm 74% e buxhetit ishte shpenzuar. Ekzekutimi i buxhetit për investimet kapitale i prezantuar në 15,341,962€, në kuadër të këtij realizimi përfshihen edhe pagesat në vlerë prej 2,432,034€ për borxhet e akumuluar nga vitet e mëhershme. Pra shpenzimet reale sipas programit për investime kapitale vlerësohet të janë vetëm 12,909,928€ apo vetëm 62% e buxhetit aktual. Po ashtu edhe dinamika e realizimit nuk është në harmoni me planifikimet sepse 42% e shpenzimeve nga kjo kategori janë realizuar në tremujorin e fund vitit. Gjithashtu, vlen të theksohet se në periudhë fund vitit janë lidhur 56% kontratave apo 97 kontrata në vlerë 6,213,219€ nga 173 kontratat tërësishme të nënshkuara gjatë vitit 2018 në vlerë prej 9,401,040€, kjo një arsye shtesë/tjetër për mos ekzekutimin të buxhetit dhe sfidë që duhet të adresohet nga menaxhmenti. Shkaku i një dukurie të tillë sipas menaxherit të prokurimit ishte mungesa e projekteve ekzekutive i përcaktuar paraprakisht si kriter ligjor para inicimit të procedurave të prokurimit.
- Tek kategoria e pagave dhe mëditje, buxheti final ishte kursyer për 211,298€ (për të cilën nuk është ofruar sqarim nga zyrtaret përgjegjës) krahasuar me buxhetin fillestar.
- Buxheti final për mallra dhe shërbime në krahasim me buxhetin fillestar ishte rritur për 490,934€, mirëpo pavarësisht kësaj niveli i realizimit ishte vetëm prej 90%. Po ashtu edhe dinamika e realizimit nuk është në harmoni me planifikimet sepse 32% e shpenzimeve nga kjo kategori janë realizuar në dymujorin e fund vitit, kjo ka ndodhur për shkak të pamundësisë së komunës për të planifikuar dhe menaxhuar mirë me buxhetin në dispozicion;
- Buxheti final për shërbimet komunale në krahasim me buxhetin fillestar ishte rritur për 163,775€ dhe komuna ka arrit të shpenzoje vetëm 61% të buxhetit për këtë kategori. Po ashtu vlen të theksohet se obligimet në këtë kategori kanë shënuar rritje për 37,000€ (nga 8,000€ sa ishin në vitin 2017, në 45,000€ në fund të vitit 2018);
- Buxheti final për kategorinë e subvencioneve është rritur për 70,844€ në krahasim me buxhetin fillestar, ndërsa janë shpenzuar 98% e buxhetit final si dhe;
- Komuna ka pranuar gjithashtu grante nga donatorët e brendshëm dhe të jashtëm në vlerën prej 561,819€, që gjatë këtij vitit ishin realizuar vetëm 30%. Kjo ka ndodhur për shkak të pamundësisë së komunës për të planifikuar dhe menaxhuar mirë me buxhetin e fondeve në dispozicion nga donatorët; si dhe;

- Po ashtu komuna ka pranuar një huamarrje në vlerë prej 523,409€, e cila ishte shpenzuar në kategorinë e mallrave prej 156,008€⁹ edhe atë në Drejtorin e Arsimit dhe Shëndetësisë.

Çështja B1- Nivel i ultë i realizimit të buxhetit

- Gjetja** Sfida kryesore me të cilën përballet komuna është ekzekutimi i buxhetit për investim kapitale. Konsiderojmë se vetëm 62% të fondeve janë përdorur për arritjen e objektivave/projekteve të planifikuara të këtij viti, sepse vlera e prezantuar prej 15,341,962€ përfshinë edhe pagesat prej 2,432,034€ për borxhet e akumuluar nga vitet e mëhershme. Niveli i ekzekutimit krahasuar me objektivat e synuar nuk ishte arritur pasi menaxhmenti nuk kishte bërë një analizë të rregullt mbi ecuritë buxhetore e cila po ashtu ka rezultuar në bartjen e të hyrave në vlerë prej 2,731,779€ në vitin vijues, si fonde të pashpenzuara.
- Rreziku** Shfrytëzimi jo efektiv i fondeve në dispozicion, do të rezultojë në mos arritjen e objektivave të organizatës, më pak projekte për qytetaret dhe në financimin e detyrimeve të vitit aktual nga buxhetet e vitit të ardhshëm.
- Rekomandimi B1** Kryetari duhet të sigurojë që performanca buxhetore është monitoruar në mënyrë sistematike në baza mujore dhe që ky rishikim i identifikon dhe adreson barrierat për realizim të buxhetit në nivel të planifikuara. Aty ku supozimet e buxhetit fillestar janë të pasakta, kjo duhet të reflektohet plotësisht në pozitën e buxhetit final.

3.1.1 Të hyrat

Pranimi i të hyrave për vitin 2018 ishte 6,307,458€, apo krahasuar me vitin e kaluar komuna ka arkëtuar më të ulët të të hyrave vetjake prej 310,241€ apo shprehur në përqindje 4.7%. Kjo është ndikuar në veçanti nga ulja e arkëtimit prej të hyrave nga lejet e ndërtimit, ku zvogëlimi është prej 22% (314,776€). Komuna ka ndaluar dhënien e lejeve të ndërtimit, për shkak të shtyrjes së ekzekutimit të vendimit për miratimin e planit rregullues urban për një periudhë kohore me urdhrin e lëshuar nga gjykata themelore e Prizrenit, si pasojë e problemeve pronësore me hekurudhat e Kosovës.

Si kategori dominuese në strukturën e të hyrave vetjake është arkëtimi i të hyrave nga tatimit në pronë në vlerë prej 2,196,722€ apo rreth 35% e totalit të të hyrave, të hyrat nga grumbullimi i mbeturinave në vlerë prej 1,184,328€, lejet e ndërtimit prej 1,098,971€ etj. Komuna ende nuk ka të vendosur kontrollë të brendshme efektive që kanë të bëjnë me mbledhjen dhe raportimin e të hyrave, përfshirë agregimin e tyre në PFV.

⁹ Në Drejtorin e Shëndetësisë prej 148,336€ dhe në vlerë prej 7,672€ në Drejtorin e Arsimit.

Komuna gjatë këtij viti ka pranuar edhe të hyra në vlerë prej 878,991€ (nga dënimet e policisë

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2018 Pranimet	2017 Pranimet	2016 Pranimet
Të hyrat vetjake	8,121,284	8,121,284 ¹⁰	6,307,458	6,617,699	6,292,849

në vlerë prej 779,169€ gjobat e gjykatave në vlerë prej 81,820€, dhe agjencinë të pyjeve 18,002€). Gjatë vitit 2018 komuna ka shpenzuar të hyrat në vlerë prej 7,683,672€, kryesisht për projekte kapitale 59% apo 4,525,377€.

Tabela 3. Të hyrat vetjake (në €)

Çështja A1- Qarkullimi i mjeteve jashtë Llogarisë së Vetme të Thesarit

Gjetja

Sipas nenin 16, pika 3 e LMFP-së – “Pranimi i parave publike”, të gjitha paratë publike (përfshirë këtu edhe ato para që pas pranimit shndërrohen në para publike) menjëherë depozitohen në një llogari zyrtare bankare të krijuar ose të përcaktuar nga Thesari. Ndërsa tek Rregullorja financiare nr.03/2010 për të hyrat vetjake neni 7 precizohen për secilën organizatë buxhetore departamenti i thesarit në kuadër të llogarisë kryesore të BQK, hap nën-llogari bankare për mbledhjen e parave publike.

Biblioteka e qytetit “Xhemajli Berisha” e cila vepron si njësi në kuadër të drejtorisë së kulturës, gjatë vitit 2018 kishte të hyra në vlerë 8,167€ (përfshirë edhe të barturat nga viti kaluar) dhe shpenzime në vlerë 4,443€. Këto të hyra dhe shpenzime janë menaxhuar në para të gatshëm dhe nga një llogari bankare jo e autorizuar, dhe nuk janë prezantuar dhe shpalosur në PVF. Me rastin e kalimit të Bibliotekës së Qytetit nga Ministria në kuadër të komunës, nuk është përcaktuar një UNIREF për grumbullimin dhe depozitim të të hyrave në llogarinë e komunës. Një dukuri e tillë ka ndodhur nga neglizhenca dhe profesionalizmi i zyrtarëve përgjegjës të kësaj njësie, por edhe mungesa e mbikëqyrjes të menaxhmentit të drejtorisë përkatëse komunale.

¹⁰ Në totalin e të hyrave të planifikuar janë prezantuara dhe të hyrat indirektë (550,000€) dhe atë; Gjobat në trafik prej 450,000€, gjobat e gjykatës 120,000€ si dhe të hyrat nga agjencia i pyjeve në vlerë prej 15,000€.

Rreziku Kryerja e transaksioneve përmes llogarisë të pa autorizuar, shpie në keq deklarim të të hyrave apo shpenzimeve. Financimi i aktiviteteve të mësipërme është jashtë kornizës ligjore mbi shpenzimin e parasë publike dhe nuk ka siguri të mjaftueshme nëse mjetet vërtetë kanë arritur qëllimin, si dhe nuk mundëson kontrolle adekuate ndaj këtyre burimeve.

Rekomandimi A1 Kryetari duhet të veproj, marr masa për të rregulluar menaxhimin financiar të bibliotekës duke futur në sistem këtë njësi. Pranimi i mjeteve publike duhet të depozitohen në llogarinë zyrtare bankare të përcaktuar nga Thesari dhe shpenzimi i këtyre mjeteve duhet të bëhet në përputhje me rregullat.

Çështja A2 - Mos barazimi i të hyrave në mes drejtorive përkatëse

Gjetja Komuna nuk bën barazim e të dhënave duke përfshirë saldot mujore për të hyrat nga drejtoria e Kadastër me gjeodezinë, QKMF-së dhe urbanizminuk janë barazuar në mënyrë sistematike (çdo muaj) gjatë vitit 2018 me zyrтарin kryesor për të hyra siç kërkohet me rregullën Nr. 03/2010 neni 13.3. Kjo situatë është për shkak të neglizhencave të zyrtareve të drejtorive përkatëse.

Rreziku Mos harmonizimet e të hyrave, ndikojnë në raportimin jo të drejtë të të hyrave apo evidentimin e klasifikimeve të mundshme në kode të gabuara të transaksioneve.

Rekomandimi A2 Kryetari duhet të sigurojë se barazimet në mes të drejtorive përkatëse kryhen në baza të rregullta mujore dhe të gjitha mospërputhjet e mundshme të sqarohen me kohë.

Çështja B2 - Mangësi në menaxhimin e të hyrave nga tatimi në pronë.

Gjetja Bazuar në Udhëzimin Administrativ 03/2011-“Mbi regjistrimin e pronës”, neni 16 i cili rregullon që “Të gjitha objektet e papërfunduara duhet të tatimohen me 40% të vlerës së tregut të objekteve të banimit dhe në llogaritjen e tatimit nuk do të përfshihet zbritja prej 10,000€, shkalla e amortizimit dhe cilësia e ndërtimit. Kemi identifikuar se në pesë raste komuna nuk kishte vepruar në përputhje me ligjin për arsye se kishte tatimpagues që posedonin dy apo më tepër prona të regjistruara për banim kryesor dhe për secilën pronë, është aplikuar zbritja prej 10,000€. Gjithashtu, bazuar në analizën e bazës së tatimit në pronë (protaxi nga komuna) kemi konstatuar se rreth 680 prona (nga 36,990 prona të evidentuar për banim), komuna ka lejuar zbritjen e parregullt. Efekti i këtyre zbritjeve të parregullta ndikon që komuna të ketë ngarkesa tatimore me të ulëta në vlerë të përafërt prej 10,200€, gjegjësisht të hyrat me të pakta nga tatimi në pronë. Sipas zyrtareve komunal nuk i lejohet ndryshimi i të dhënave pasi sistemi menaxhohet nga niveli qendror. Shkaku për këtë sipas

zyrtareve përgjegjës ka qene tek softueri i ri i tatimit në pronë (2009), i cili është zëvendësuar (para këtij ka qene në Access) para hyrjes në fuqi të Ligjit mbi Pronën e Paluajtshme dhe ndryshimet në sistem mund ti bëj vetëm niveli qendror. Mos angazhimi i zyrtareve kompetent komunal dhe përgjegjësit e tatimit në pronë janë arsytet për zbritjet e pa rregullta të cilët nuk kanë prezantuar me kohë gabimet të zyrtarët e nivelit qendror për korrigjimet e duhura; si dhe

Në gjashte raste pronat e papërfunduara janë vlerësuar me norme të kualitetit të ndërtimit 1.1-shkelqyeshem e cila ka rritur shumën e tatimit të vlerësuar. Shuma e mbivlerësuar e faturimit tatimpaguesit për gjashtë rastet është rreth 295€. Edhe pse efekti financiar i mospërputhjeve të evidentuara nuk konsiderohet se është i lartë, vet fakti i ekzistimit të mangësive të tilla është tregues i mungesës së efektivitetit të kontrolleve të brendshme. Shkaku për këtë është mos verifikimi në teren i këtyre objekteve dhe ka rezultuar që të vlerësohen me norme të shkëlqyeshme.

Rreziku

Mos aplikimi i ngarkesave sipas kërkesave ligjore të tatimit në pronë rrit rrezikun që të hyrat prej kësaj kategorie të jenë më të ulëta si dhe mungesa e kontrolleve efektive në menaxhimin e të hyrave nga tatimi në pronë do të vazhdojë të rezultojë me shkallë të ulët të arkëtimit, kurse me rastin e mbivlerësimit të barrës tatimore, komuna i ekspozohet humbjes së besimit për trajtim të drejt të tatimpaguesve dhe mund të përballet me padi nga taksapaguesit.

Rekomandimi B2 Kryetari duhet të vendos kontrolle të qëndrueshme që sigurojnë një arkëtim efektiv të të hyrave, duke përfshirë dhe përcaktuar vlerësimin e drejtë të barrës tatimore në përputhje me rregullat dhe gjendjen faktike në teren duke angazhuar anketues kompetent.

Çështja A3 - Mangësi në llogaritjen e bazës së tatimi në pronë

Gjetja

Sipas nenit 11 të Ligjit të Tatimit në pronë çdo komunë është përgjegjëse për menaxhimin e informatave tatimore mbi pronën dhe futja e të dhënave në bazën qendrore, si dhe përgatitja dhe lëshimi i faturave të tatimit. Neni 2 i Rregullores për aplikimin e tatimit në prone, në Komunën e Prizrenit i ka përcaktuar gjashtë (6) zona të qytetit.

Në pesë (5) raste, faturat e tatimpaguesve janë mbivlerësuar sepse zonat komunale të fatura e tatimit në pronë nuk janë në përputhje me zonat Komunale (rrugët e qytetit) sipas Rregullores. Në njërin rast kjo dukuri ka ndodh për arsye se veprimtaria tatimpaguesit ishte punishte dhe norma e tatimit duhet të jetë 0.16% e jo si është faturuar me 0.18%, duke mbivlerësuar barrën tatimore për 21€. Ndërsa në katër rastet tjera, diferencë/mbivlerësim ishte prej 4,311€ sepse faturimi sipas tarifave është

përcaktuar për zonën e II, ndërsa pronat sipas Rregullores i takojnë zonës së III; si dhe

Komuna nuk kishte bërë përcaktimin zonal për rrugët “Besim Shala” që kishte të evidentuara 68 prona dhe “Atnan Krasniqi” të evidentuar 162 prona. Në dy raste të audituara, faturimi është bërë sipas zonës së II-të, pa bazë të përcaktuar në rregullore.

Rreziku

Mos aplikimi i ngarkesave sipas kërkesave ligjore të tatimit në pronë rrit rrezikun që të pranohen të hyra të parregullta nga kjo kategori duke ofruar mundësin edhe të ankesave nga palët për ngarkesë të pa sakta. Mos përputhja e zonave komunale gjatë faturimit për tatimin në pronë mund të ndikoj që një numër i qytetareve të paguaj sipas tarifave të cilat nuk i takojnë asaj zone, ku mund të rezultojë deri të ngarkesa të pa sakta se sa tarifat e parapara me rregullore në njërën anë dhe përfitimin e fondeve me të ulëta me këto raste.

Rekomandimi A3 Kryetari duhet të siguroj veprime shtesë si dhe të marrin veprim iniciues për përditësimin e rregullores në Asamblenë Komunale si dhe ndarjen e duhur të këtyre zonave tatimore me gjendjen faktike në teren.

Çështja B3 - Dobësi në menaxhimin e kontratave me koncesion dhe qiradhënie

Gjetja

Komuna ka treguar dobësi në menaxhimin e pronave të dhëna me koncesioni apo në shfrytëzim, si në vijim:

- Bazuar në “Marrëveshjen mbi Koncesionin” e datës 01.08.2001, Neni 4.6 citohet; Komuna ka të drejte ta përfundojë marrëveshjen në çdo kohë për shkaqe vijuese: falimentimin e përfituesit, paaftësinë pagesë, shkelje materiale të obligimeve, vonesa në pagim (pas tri vërejtjeve), shfrytëzimi i lokacionit për qëllime të tjera nga ato që janë modifikuar në marrëveshje”. Në dy rastet e audituara, kontrata për shfrytëzimin e pronës publike me koncesion kishte skaduar që nga viti 2013, për tregjet “B. Curri” dhe “Qylhani”. Komuna në dy vitet e fundit nuk ka faturuar për këta shfrytëzues dhe borxhi ishte nënvlerësuar pasi që është prezantuar në vlerë prej 252,000€ ndërsa sipas gjendjes faktike duhet të arrinte vlerën prej 429,940€. Po ashtu përfituesi „Alcom Construction” ka kontratë me komunën për shfrytëzimin e pronës komunale me koncesion me një afat 10 vjeçar (deri me datën 21.01.2019) arkëtimi nga ky qiramarrës deri në 31/12/2018 ishte zero dhe obligimi i kompanisë sipas kartelës është prej 21,240€. Komuna për rastet e lartshënuar nuk ka ndërmarr ndonjë masë preventive, nuk ka ngritur padi në gjykatë për arkëtimin e borxhit, apo së paku nuk ka respektuar nenin 7 dhe 8 të kontratës së nënshkruar mes palëve ku citohet se me rastin e mos kryerjes se obligimeve mujore qiradhënësi (komuna) të veprojë me masa

administrative për mbylljen e tregut. Auditori për të njëjtën çështje ka tërheq vëmendjen edhe në raportet e viteve të kaluar.

- Ligji për dhënien në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme komunale Nr.04/L44”, neni 5 thotë: “Procedurat për dhënien e pronës së paluajtshme komunale në shfrytëzim afatshkurtër, realizohen përmes konkurrencës së hapur publike dhe procedurave të parapara me këtë ligj”. Komuna edhe në vitin 2018 (nga viti 2016) kishte dhënë tetë kontrata për shfrytëzimin e pronës komunale/lokale me çmim prej 1€ në muaj, për partitë politike duke mos organizuar ankande publike siç kërkohet me Ligjin për dhënien në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme komunale. Këto lokale ishin dhënë duke u bazuar në vendimin e asamblesë komunale që ishte nxjerrë në vitin 2005.
- Ndërsa nga njëmbëdhjete (11) rastet e audituara të hapësirave publike të dhëna në shfrytëzim (lokaleve), shfrytëzuesit nuk kanë kryer obligimet dhe vlera e obligimit deri në fund të vitit 2018, arrin vlerën 206,565€.

Shkaku për këtë është mos implementimi me kohë i kushteve të kontratës me shfrytëzuesit e hapësirave dhe mos ndërmarrja e masave të nevojshme nga ana e komunës.

Rreziku

Menaxhimi i dobët i kontratave për pronat e dhëna me qira ka rezultuar me rritje e llogarive të pa mbledhshëm për të hyrat nga pronat publike. Mos gatishmëria për të ndërmarrë masa efikase për arkëtimin e të hyrave, rrit rrezikun e mos realizimit të planit për të hyra dhe reflekton me më pak projekte kapitale të planifikuar të financohen nga këto fonde.

Rekomandimi B3 Kryetari duhet të shqyrtoj arsyet e gjendjes ekzistuese dhe të vendos masat e duhura që brenda një periudhe të arsyeshme të arkëtoj të gjitha borxhet e prapambetura, ose në të kundërtën, të ndaloj shfrytëzimin e pronave publike pronarëve, të cilët nuk i kanë kryer obligimet ndaj Komunës.

Çështja A4 Dobësi në menaxhimin e të hyrat nga sektori i mbeturinave

Gjetja

Sipas Rregullores “Mbi Menaxhimin e Mbeturinave në Komunën e Prizrenit”, komuna ka marrë përsipër faturimin dhe arkëtimin për amvisëri. Neni 9 dhe shtojca 1, përcakton tarifa e taksës për mbeturina për amvisnit për zonën urbane dhe rurale është në shume prej 4.50€ për muaj ose 54€ për vit. Komuna kishte kontraktuar tri (3) kompani për grumbullimit të mbeturinave në vende urbane dhe rurale. Ndërsa për menaxhimin e të dhënave të konsumatorëve të shërbimeve për grumbullimin e mbeturinave, komuna përdorë një program softuerik por ky program nuk gjeneron sipas nevojës së komunës pasqyra të azhurnuara financiare si ditore, javore, mujore.

Komuna në programin e menaxhimit të mbeturinave e përdor data bazë të tatimit në pronë të vitit 2014 duke mos e bërë rifreskimin e të dhënave bazuar në rritjen e amvisërive. Duke e krahasuar numrin e amvisërive të data bazës të tatimit në pronë të vitit 2018 me atë të vitit 2014 kemi një diferencë apo rritje të numrit të amvisërive prej rreth 2500, çka nënkupton se komuna do të mbledhë me pakë të hyra në shume prej 135,000€.

Po ashtu rreth 3500 amvisëri të cilët janë me punë jashtë shtetit, komuna i ka faturuar dhe arkëtuar tarifën për mbeturina në shume prej 12€/për vit pa ndonjë bazë ligjore (vendim të Kuvendit Komunal). Kjo nënkupton se komuna mbledhë me pakë të hyra në shume prej 147,000€ pasi ngarkesa e tarifës vjetore duhet të ishte 54€ Shkaku për këtë janë ankesat e familjeve jashtë vendit për të mos paguar njëjtë me të tjerët.

Rreziku Mos azhurnimi i të dhënave sipas gjendjes faktike në teren si dhe mos aplikimi i ngarkesave sipas kërkesave ligjore apo rregullore të aprovuar për grumbullimin e mbeturinave rrit rrezikun që të hyrat prej kësaj kategorie të jenë më të ulëta.

Rekomandimi A4 Kryetari duhet të sigurojë se do të kryhen analiza të mirëfillta nga menaxhimi i mbeturinave në mënyrë që të arrihen objektivat e komunës në krijimin e sistemit të qëndrueshëm financiar. Po ashtu, të merret në konsideratë që paraprakisht të rifreskohet data baza e ngarkesave si dhe të bëhen ndryshimet dhe aprovimet në rregullore nga organi legjislativ për lirin apo përcaktimin e tarifa për amvisëritë e caktuara.

Çështja A5 - Fituesi i ofertës për shfrytëzimin e lokaleve afariste me çmim më të ulët

Gjetja Bazuar në nenin 6-“Kriteret e ankandit” i “Rregullores me Nr. 23/2013-për Përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimit të pronës së paluajtshme të komunës, citohet se: “Përmes ankandit publik bëhet përzgjedhja e fituesit në bazë të çmimit më të lartë të ofruar në ankand publik” .

Komuna në përzgjedhjen e fituesve për dhënën në shfrytëzime të lokaleve në pronësi komunale, ka përdorur kriterin “Ekonomikisht më i favorshëm”, duke përdorur nën kritere, jo të matshme dhe jo relevante për këtë proces dhe kjo ka pamundësuar përzgjedhjen e ofertuesit me çmimin më të favorshëm apo të përfitimit të çmimin më të lart nga komuna për pronën e ofruar në shfrytëzim. Po ashtu edhe komisioni i ankesave i formuar pranë komunës i cili gjatë analizimit të ofertave dhe ankesave, ka konstatuar se ankesat e dy ofertuesve që kanë ofruar çmimin më të lartë për m² kanë qenë të arsyeshme. Me këtë rast vlerësojmë se komuna pranon 5,748€ me pak të hyra vjetore, për shkak të kriterëve joadekuate të përdorura, në kundërshtim edhe me legjislacionin në fuqi gjatë procesit të ankandit publik. Kjo edhe për shkak të kompetencës jo profesionale me rastin e përcaktimit të kriterëve.

Rreziku Praktika të tilla dëmtojnë reputacionin e komunës dhe humbin besimin e ofertuesve potencial në një proces të drejtë dhe transparent të ankandit publik. Gjithashtu, mos përzgjedhja e fituesit në bazë të çmimit më të lartë të ofruar rezulton edhe me më pak të hyra nga qiratë.

Rekomandimi A5 Kryetari duhet të sigurojë se personat përgjegjës respektojnë Rregulloren për dhënien në shfrytëzim të hapësirave publike përmes ankandit publik dhe kriteret e vendosura të bazohen në rregulla duke ofruar mundësin e përfitimeve maksimale nga procesi i ankandit.

3.1.2 Pagat dhe mëditjet

Pagat dhe shtesat paguhen përmes një sistemi të centralizuar të pagesave që menaxhohet nga MAP dhe MF. Buxheti final për kategorinë e pagave dhe mëditjeve ishte prej 19,745,113€, ndërsa shpenzimet ishin prej 19,495,068€ apo 99%. Kontrollët kyçe duhet të konfirmojnë saktësinë dhe plotësinë e pagesave si aprovimi dhe futja në listë të pagave të punonjësve, verifikimi i numrit të lejuar dhe kontrollët tjera dhe aprovimi i buxhetit për paga dhe mëditje nga asambleja komunale. Po ashtu, kemi rishikuar nëse punonjësit janë paguar sipas kontratës.

Menaxhimi i personelit

Numri i stafit të miratuar ishte 3,101 punonjës, ndërsa numri aktual i punonjësve është 3,058 punonjës. Ne kemi testuar disa procedura të rekrutimit si dhe dosjet e personelit për të verifikuar rregullsinë e tyre.

Çështja A6- Mangësi në procesin e rekrutimit të stafit

Gjetja Sipas Ligjit të Punës, Neni 8, Punëdhënësi në sektorin publik, është i obliguar që të shpall konkurs publik sa herë që pranon një punëmarrës dhe themelon një marrëdhënie të punës. Konkursi duhet të jetë i barabartë për të gjithë kandidatët e synuar, pa asnjë lloj diskriminimi, ashtu siç parashihet me këtë ligj dhe aktet tjera në fuqi. Në dy raste, dhe atë; Për punësimin e një mësimdhënësi sipas konkursit nr. 2719/2018 të datës 02.10.2018 në shkollën fillore "Atmaxha" dhe shkollën "A. Frashri" konkursi nr. 2613/2018 për pranimin e një profesorit të gjuhës gjermane, kemi identifikuar se nuk ka thirrje publike në gazetë.

Për punësimin e një stomatologu në shkollën SHML "Luciano Motroni" konkursi me nr. 2115/2018 i datës 08.08.2018, mungon dëshmia mbi përvojën e punës. Ndërsa në rastin tjetër për punësimin e një mësimdhënësi sipas konkursit nr.2719/2018 të datës 02.10.2018 në shkollën fillore "Atmaxha" në dosje mungon dëshmia e kërkuar për trajnime profesionale. Po ashtu kemi identifikuar se rekomandimi për pranimin e mësimdhënësit në punë nga komisioni vlerësues është bërë me datë 17.08.2018 derisa konkursi mbante datën 02.10.2018, pra rekomandimi për pranim është bërë para konkursit.

Po ashtu me rastin e pranimit një mësimdhënëse në Shkollën Fillore "Ibrahim Fehmiu", konkursi i datës 08/8/2018, kemi identifikuar se testi me shkrim i kandidatit të përzgjedhur nuk ishte nënshkruar nga komisioni vlerësues. Në këtë rast kemi identifikuar se edhe rekomandimi për pranimin në punë nga komisioni vlerësues (me datë 17.08.2018) ishte bërë para përfundimit të testit me shkrime (i mbajtur me datën 04/9/2018) dhe intervistës (organizuar me datën 27/9/2018).

Rreziku Prania e parregullsive në procesin e rekrutimit mund të rezultojnë në konkurrencë të padrejtë si dhe mos punësim të personelit adekuat.

Rekomandimi A6 Kryetari duhet të sigurojë se janë ndërmarrë veprime të menjëhershme për ta shqyrtuar këtë proces të punësimit, si dhe të sigurojë kontrolle efektive në mënyrë që proceset e rekrutimit të bëhen në përputhje të plotë me kërkesat e ligjit të punës.

Çështja A7- Mangësi në procedura rekrutimi për shërbimin civil

Gjetja Neni 11 Ligjit Nr. 03/1-149 për Shërbimin Civil përcakton pranimi në shërbimin civil në pajtim me parimet e meritës, aftësisë profesionale, paanshmërisë, mundësive të barabarta, mos diskriminimit dhe përfaqësimit të barabartë dhe në bazë të konkursit publik dhe pas verifikimit të zotësisë së veprimit të kandidatëve. Gjithashtu, edhe kriteret,

kushtet dokumentacioni i kërkuar në konkurset publik nr. 01-111-58872 datë 24.04.2018 në Drejtorin e Inspektoratit për pozitën inspektor ndërtimi kërkohej përvojë pune profesionale 3 (tri) vite.

Kandidati i përzgjedhur në konkursin e shpallur nuk e plotësonte kushtin për përvojën e punës sipas kërkesave të konkursit i cili ka sjelle një reference për përvojën e punës profesionale si arkitekte nga një kompani projektimi dhe ndërtimi, ku në kompani kandidati kishte vetëm dy vite përvojë pune profesionale. Po në dokumentin e trustit të kursimeve pensionale për të njëjtin kandidatit vërteton se kishte punuar në një kompani që aktivitet ka tregtinë me pakicë të mallrave, pra referenca për përvojën profesionale si arkitekte nuk ishte relevante. Shkaku i kësaj ishte jo profesionalizmi, vlerësimi jo objektiv i personave përgjegjës, për përzgjedhjen e kandidateve meritor për këtë pozitë.

Rreziku Punësimi i tillë nuk siguron konkurrencë dhe transparencë, humbjen e imazhit të komunës dhe shton rrezikun për përzgjedhjen e kandidatëve pa shkathtësitë dhe përvojat e duhura profesionale.

Rekomandimi A7 Kryetari të siguroj që emërimet e kandidatëve bëhen vetëm pasi të jenë zbatuar të gjitha procedurat e rekrutimit dhe emërimit në përputhje me ligjet dhe rregulloret në fuqi.

Çështja A8 - Mungesë e dosjeve të personelit dhe pagesa pa bazë ligjore

Gjetja Për 29 zyrtarë të cilët janë të angazhuar në Drejtorinë për Emergjencë dhe Siguri, komuna nuk ishte në gjendje të na ofrojnë dosjet e kompletuara dhe kontratat e këtyre zyrtarëve, në bazë të cilave kryhet kompensimi i pagave. Sipas menaxherit të personelit nuk ka dokumentacion relevant për këta zyrtar dhe kjo dukuri është shfaqur si pasojë e një memorandumi të nënshkruar vite me parë, pasi që zyrtarët janë pjesë e Ministrisë së Punëve të Brendshme, ndërsa kompensimi i pagave dhe kompensimet e tjera kryhen nga komuna. Kjo pasqyron një mungesë të specifika ve të qarta për Burimet Njerëzore të Komunës.

Qeveria e Kosovës në bazë të vendimit me Nr. 11/26 i datës 19/05 2010 precizon, të gjithë të kategorizuarit si nën punës civil sipas Ligjit për Shërbimin Civil do të përfitojnë mjete financiare në baza mujore në vlerë prej 30€ bruto. Për më tepër sipas të dhënave të kërkuar nga sektori i MPB kemi identifikuar se të këto zyrtar nuk janë të kategorizuar si nëpunës civil, ndërsa kompensohen me shtesën prej 31.2€ për muaj, që në total gjatë vitit 2018 këta punëtorë janë kompensuar në vlerë prej 10,826€.

Rreziku Pagesat për zyrtarët në mungesë të dokumentacionit relevant, rezulton në pamundësinë për të justifikuar pagën/shtesat ose për të mundësuar shqyrtimin e rezultateve nga vlerësimet e performancës, po ashtu pagesat e shtesave në kundërshtim me vendimin e qeverisë, janë pagesa të parregullta dhe shkaktojnë dëmtim të buxhetit të komunës.

Rekomandimi A8 Kryetari të siguroj rishikimin e mundësisë që këta zyrtarë të transferohen në institucionet ku ata punojnë, ose të kompletohen dosjet e tyre në komunë për të krijuar bazë ligjore për ekzekutimin e pagave të tyre. Pagesat e shtesave bëhen vetëm për zyrtarët që parashihen me vendimin e Qeverisë dhe shumat e përfituara në kundërshtim me këtë vendim ti kthehen buxhetit të komunës.

Çështja B4- Dosjet e pa azhurnuara të personelit

Gjetja Vendimit i Qeverisë Nr. 06/29 i datës 15.05.2015, kërkon një vendim të vërtetuar nga zyrtarët e autorizuar të personelit për dëshminë e viteve të përvojës së punës. Po ashtu Ligji Nr. 04/L-032 për arsimin para universitar neni 20 paragrafi 2.2 përcakton se drejtori i institucionit arsimor ka përgjegjësi ekzekutive në menaxhimin dhe administrimin e përgjithshëm të institucionit duke përfshirë detyrat e caktuara për vlerësimin, disiplinën dhe çështjet e tjera që kanë të bëjnë me mësimdhënësit dhe punëtorët e tjerë të arsimit. Në 11 raste në drejtorinë e arsimit, dëshmitë për vitet e përvojës së punës nuk ishin të pasqyruara në një vendim të vërtetuar nga zyrtarët e autorizuar të personelit, si bazë për kompensim. Po ashtu në drejtorinë e arsimit në dosje mungonin kërkesat e pushimeve si dhe vlerësimet e performancës. Shkaku i kësaj ishte mos koordinimi në mes të shkollave dhe drejtorisë së arsimit si dhe neglizhenca e menaxhmentit dhe stafit përgjegjës.

Rreziku Pagesat e bëra pa dëshmi përkatëse rrisin rrezikun e kompensimit jo real të shtesës për përvojën e punës. Po ashtu mungesa e vlerësimeve të stafit nuk ofron një pasqyrë të saktë të performancës së arritur.

Rekomandimi B4 Kryetari të sigurohet se drejtoret e institucioneve arsimore dhe menaxheri i personelit duhet të kompletojnë dëshmitë për përvojën e punës për të krijuar bazë ligjore për ekzekutimin e shtesës në bazë të përvojës. Po ashtu drejtoret e shkollave të monitorojë vlerësimet e performancës dhe dëshmitë e njëjta të vendosen në dosje të personelit.

Çështja A9 -Zyrtaret pa kontratë valide të punës

Gjetja Ligji i Punës nr. 03/1-212 neni 10 Kontrata e Punës e obligon Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare (QKMF) në Prizren që të lidhe kontrata pune me të punësuarit.

Gjatë auditimit të dosjeve të personelit kemi identifikuar se udhëheqësi i financave në QKMF - Departamenti administratës nga data 31.12.2013 kompensohet pa kontratë punë. Drejtori i QKMF-se për çdo vit nga 2014 deri në vitin 2018 kishte bërë Akt emërimi me një afat një vjeçar me vendim mbi emërimin në vendin e punës. Shkaku i kësaj dukurie ishte mos përgjegjësia profesionale e zyrtarit të personelit dhe menaxhmentit përgjegjës pranë QKMF-së.

Rreziku Në mungesë të kontrolleve në menaxhimin e personelit, përfshirë dosjet e personelit të pakompletuara (kontratat e skaduar) do të rezultojnë më kompensime të parregullta si dhe e rrezikojnë cilësinë e procesit në përgjithësi.

Rekomandimi A9 Kryetari i komunës duhet të siguroj se para skadimit të kontratave të punëtorëve të fillohet me procedurat e rekrutimit apo nëse paraqitet nevoja për vazhdimin e kontratave, procedurat e vazhimit të jenë në përputhje me rregullat dhe udhëzimet në fuqi.

Çështja A10 - Kompensimin jo i rregullt i pushimit të lehonisë

Gjetja Sipas UA nr. 05/2011 për procedurat e pagesës së lehonave, neni 4 e përcakton se, gjashtë muajt e parë të pushimit të lehonisë, zyrtarët paguhet nga institucioni me kompensim 70% të pagës bazë. Në tri raste¹¹, komuna ka kompensuar me pagën e plot, duke mos aplikuar ndalesat për pushimin e lehonisë. Shkak i këtyre pagesave ishte mos koordinimi në mes të shkollave dhe Drejtorisë së arsimit. Nga rastet e testuar buxheti i komunës ishte dëmtuar për 994€, edhe pse efekti financiar i mospërputhjeve të evidentuara nuk konsiderohet se është i lartë, vet fakti i ekzistimit të mangësive të tilla është tregues i mungesës së efektivitetit të kontrolleve të brendshme.

Rreziku Pagesa e plotë e pushimit të lehonave ka rezultuar me pagesat jashtë procedurave ligjore dhe dëmtim të buxhetit Komunal.

¹¹ Sipas vendimi nga 01.11.2017 deri 01.05.2018 për pushim të lehonisë, nuk është aplikuar ndalesa nga komuna dhe kompensimi për muajin janar dhe shkurt të vitit 2018 ishte i plot. Rasti i dytë, vendim pushimi të lehonës ishte vazhduar pa pagesë edhe për tre muaj nga 01.02.2018 e deri me 30.04.2018, por kompensimi është bërë me pagë të plotë për muajin shkurt dhe mars 2018, dhe rastin i tretë pushimi i lehonisë sipas vendimit ishte nga data 19.07.2018 e deri me datën 19.01.2019, mirëpo kompensimi është bërë me pagë të plotë edhe për muajin gusht 2018.

Rekomandimi A10 Kryetari të sigurojë që personeli kompetent përcjell me kohë ndryshimet në listën e pagave dhe ndalesat e pushimit të lehonisë behën sipas rregullave dhe aplikohen në periudhën e duhur kohore.

3.1.3 Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale

Buxheti final për mallra dhe shërbime, komunal në vitin 2018 ishte 7,497,528€. Prej tyre ishin shpenzuar 6,372,829€, apo 85 %.

Çështja B5 - Parregullsi në angazhimin e stafit për shërbime të veçanta

Gjetja Neni 12 pika 4 e Ligjit për Shërbimin Civil (LShC), emërimet me afat të caktuar për një periudhë më të shkurtër se gjashtë muaj do të bëhen në bazë të kontratave të quajtura “Marrëveshje për shërbime të veçanta - MSHV” të cilat i nënshtrohen Ligjit për Detyrimet dhe për të cilat zbatohet një procedurë e thjeshtësuar e rekrutimit.

Komuna në vitin 2018 kishte pranuar (65) punonjës me MSHV, ku tri punonjës në pozitë bashkëpunëtor profesional për regjistrimin e tatimit në pronë ishin paguar në kohëzgjatje mbi gjashtë muaj. Një dukuri e tillë sipas menaxherit të personalit ka ndodhur për shkak të nevojës së mëtejme për angazhimin e stafit për realizimin e objektivave shtesë të komunës.

Rreziku Angazhimet e tilla rezultojnë me parregullsi ligjore dhe mungesa e monitorimit, rrit rrezikon që komuna të pranojë si kundërvlerë kontributin/performancën /shërbimi e duhur nga staf i angazhuar në këtë formë.

Rekomandimi B5 Kryetari duhet të sigurojë se marrëveshjet për shërbime të veçanta të planifikohen drejt dhe angazhimet për këto shërbime të mos zgjasin më shumë se gjashtë muaj. Po ashtu kryetari duhet të sigurojë se punonjësit me kontrata për shërbime të veçanta do të angazhohen vetëm në rastet kur ka kërkesa specifike.

Çështja A11- Parregullsi në shpenzimet për udhëtime zyrtare

Gjetja Sipas Udhëzimit Administrativ Nr. MSHP 2004/07 për udhëtimet zyrtare përkatësisht neni 2 i këtij udhëzimi “udhëtimet zyrtare nënkuptohen ato lëvizje të cilat kanë një destinacion apo qëllim i cili shërben për kryerjen e detyrave zyrtare në interes të Qeverisë së Kosovës dhe të shërbimit civil të Kosovës”. Në një rast komuna kishte paguar shumën prej 3,000€ për udhëtime zyrtare jashtë vendit sipas vendimit të kryetarit për tre persona të cilët ishin pjesë e një projekti dhe nuk ishin zyrtar komunal por të njëjtit ishin pjesë e shoqatave jo qeveritare. Shkaku i ndodhjes së rastit të tillë sipas zyrtareve përgjegjës ishte sepse ata kanë qene pjesë e një projekti dhe nuk kanë pasur mundësi pagese tjetër.

Rreziku Pagesat për pjesëmarrje në udhëtime zyrtare të personave të cilët nuk janë pjesë e stafit komunal, shkakton kosto shtesë dhe të panevojshme për komunën duke shpenzuar buxhetin e destinuar për zyrtaret komunal.

Rekomandimi A11 Kryetari duhet të fillojë një shqyrtim gjithëpërfshirës si dhe financimi i udhëtimeve të personave jashtë komunës të bëhet vetëm në rastet kur pjesëmarrja e personave të tillë sjell përfitime direktë për komunën dhe në harmoni me legjislacionin në fuqi.

3.1.4 Subvencionet dhe transferet

Buxheti final për subvencione dhe transfere ishte 548,459€. Prej tyre në 2018 ishin shpenzuar 539,906€ apo 98%. Ato kanë të bëjnë me subvencionimin për entitete publike: klube të sportit, OJQ të ndryshme, shoqëri kulturo artistike, si dhe për përfitues individual etj.

Rekomandimi

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.1.5 Investimet kapitale

Buxheti aktual për kategorinë e Investimeve Kapitale është: 20,779,831€ ndërsa shpenzimet përgjatë periudhës Janar-Dhjetor janë: 15,341,962€ ose shprehur në përqindje 74% e buxhetit. Ato kanë të bëjnë me ndërtimin e rrugëve, kanalizimeve, objekteve shkollore, objekteve për banim social etj. Në krahasim me vitin e kaluar, vërehet një ekzekutim më një performancë më të mirë e buxhetit në këtë kategori për 1,357,756€, apo rreth 10%.

Çështja C2 - Dobësi sistematike në menaxhimin e pagesave dhe pranimin e punëve për investime

Gjetja Bazuar në Rregullën financiare Nr.01/2013 për shpenzimin e parasë publike, përkatësisht neni 26, pika 2 specifikohet, “se për procedim të pagesës duhet të prezantohet kopja e kontratës që është nënshkruar nga zyrtari përgjegjës i prokurimit si kopje autentike e origjinalit, raporti i pranimin, si dhe fatura origjinale”.

Tek projekti “Ndërtimi i objektit të ri shkollor “Ekrem Rexha” në Gërnqare të Prizrenit”, komuna ka paguar faturën për Situacionin e trembëdhjetë (13) në vlerë 30,000€, bazuar në raportin e pranimin të punimeve i datës 15.11.2018 i vërtetuar nga menaxheri i kontratës. Brenda këtij situacioni ishte i përfshirë edhe pozicioni me Nr.2 tek Punët e ndryshme – Furnizimi dhe montimi i pllakave nga graniti artificial në holle- dhe korridore, me ngjyrë dhe dizajn sipas kërkesës së projektuesit në sipërfaqe prej 291m². Gjatë ekzaminimit fizik nga ana e ekipit të auditimit me prezencën edhe të

organit mbikëqyrës konstatuam se punimet për këtë pozicion nuk ishin realizuar fare. Vlera totale e këtij pozicioni të paguar ishte 4,080€ apo 14% e vlerës së situacionit.

Te kontrata “Ndërtimi i rrugëve dhe kanalizimit në fshatin Kobaj” komuna ka paguar faturën për situacionin e parë (I) në vlerë prej 35,100€, bazuar në raportin e pranimit të punimeve të datës 12/12/2018 i vërtetuar nga Organi Mbikëqyrës, ku brenda këtij situacioni ishte i përfshirë edhe pozicioni me Nr-4.1-Furnizimi, Transportimi dhe Montimi i kupëzave të betoni të klasit (C-30/37/d8cm) në sipërfaqe prej 3,963m². Gjatë ekzaminimit nga ekipi i auditimit me prezencën edhe të organit mbikëqyrës konstatuam se punimet për këtë pozicion ishin realizuar në sipërfaqe rreth 2,500m². Poashtu brenda këtij situacioni ishte i përfshirë edhe pozicioni me Nr-4.2-“Furnizimi, transportimi dhe montimi i skajoreve nga betoni të klasit (C 30/37, 18x25cm) në gjatësi prej 930m’, ku konstatuam se punimet për këtë pozicion ishin realizuar rreth 500m’. Vlera e paguar për këto dy pozicione e punëve të pa përfunduara është prej 11,298€. Shkaku i këtyre situatave është neglizhenca dhe pa përgjegjësi nga ana e mbikëqyrësve të projekteve, gjithashtu edhe tendenca për t’i shfrytëzuar mjetet në mënyrë që të njëjtat të mos barten si suficit për vitin në vijim.

Sipas Kontratës “Ndërtimi i kanalizimit dhe rrugëve në Hoqë të qytetit të Prizrenit, përkatësisht Raportit për pagesë më Nr.12 të datës 06.02.2018 “Mbikëqyrësi i projekteve të DHSP-Prizren O.E. e ka sjellë Raportin e punëve të kryera sipas situacionit të kësaj fature më nr. R.P.3/054/2017 dhe duke u bazuar në raportin e organit mbikëqyrës, Autoriteti kontraktues lejon që të bëhet pagesa e III-të në shumën prej 50,000€.” Derisa në analizën e raportit të pranimit të punëve rezulton që obligimi për pagesë të jetë: 49,660€. Shkaku i këtij mos-barazimi ishte një lëshim teknik në situacion nga ana e Organit Mbikëqyrës gjë e cili nuk u evidentua paraprakisht nga personat përgjegjës. Edhe pse efekti financiar i mospërputhjeve të evidentuara nuk konsiderohet se është i lartë, vet fakti i ekzistimit të mangësive të tilla është tregues i mungesës së efektivitetit të kontrolleve të brendshme.

Rreziku Pagesat e pozicioneve për punë të papërfunduar ose për artikuj të pa pranuar në bazë të situacioneve dhe faturimeve të tyre, rrisin rrezikun që të realizohen me një cilësi të dobët dhe jo në harmoni me standardet e kërkuara në Kontratë. Kjo gjendje ka reflektua pagesa pa mbulesë apo pagesa për punë të pa realizuar në tërësi.

Rekomandimi C2 Kryetari duhet të forcoj masat e kontrollit që dështimet e tilla të mos përsëriten. Duhet sigurohet se për mbikëqyrjen e projekteve janë vendosur zyrtar kompetent të cilët monitorojnë implementimin e kontratës dhe pranojnë vetëm punët e realizuar, nënshkruajnë situacionet sipas gjendjes faktike, në të kundërtën duhet të aplikohen masat për lëshimet e pa përgjegjshme apo neglizhente.

Çështja C3 - Inicimi i procedurave të prokurimit pa fonde të mjaftueshëm, zotimi i mjeteve pas pranimit të faturave apo pranimit të mallit dhe mungesa e projektit ekzekutiv

Gjetja Sipas rregullës financiare Nr. 01/2013 për shpenzimin e parasë publike “Asnjë kontratë publike nuk duhet të nënshkruhet pa zotim të mjeteve” gjithashtu “organizata buxhetore nuk ndërmerr asnjë obligim gjatë vitit aktual fiskal në një shumë që i tejkalon fondet e ndara”. Gjatë auditimit të procedurave të prokurimit kemi identifikuar se:

- Në dy (2) raste kontrata ishte nënshkruar pa zotim të mjaftueshëm të fondeve. Vlera totale e kontratave së nënshkruara ishte 480,602€, derisa zotimi i mjeteve për to ishte vetëm 130,000€ ose afro 27%. Gjithashtu, nga auditimi i pagesave për qëllime të pajtueshmërisë, në 12 raste komuna kishte pranuar faturën së bashku me dokumentacionin mbështetës para datës së kërkesës për zotim të mjeteve. Shkaku i një dukurie të tillë është planifikimi jo adekuat i buxhetit dhe inicimi i procedurave duke shpërfillur zbatimin e rregullave në fuqi;

Sipas Udhëzuesit të prokurimit publik, përkatësisht pika 20.13 specifikon se: Projekti Ekzekutues është një dizajn grafik i të gjitha proceseve administrative dhe inxhinierike të punimeve të kërkuara siç është përshkruar në Specifikat Teknike dhe prandaj parashtron në raste të veçanta, punime arkitektonike, strukturore të punëve që do të ekzekutohen. Autoriteti Kontraktues është përgjegjës për hartimin e Projektit Ekzekutues dhe i cili në mënyrë mandatore duhet ti bashkëngjitet (gjithashtu në pajisje elektronike) Specifikave Teknike, të cilat janë pjese të dosjes së tenderit. Asnjë Autoriteti Kontraktues nuk i lejohet që të lëshojë dokumentacionin e tenderit pa bashkëngjitur përshkrimin e hollësishëm të projektit. Kemi identifikuar se:

- Te kontrata “Ndërtimi i terreneve sportive në Prizren”, në vlerë prej 87,279€, komuna nuk kishte realizuar hartimin e projektit ekzekutiv ashtu sikur edhe kërkohet me udhëzuesin e lart cekur. Shkaqet e mos hartimit të projektit ishin neglizhenca dilemat e personave përgjegjës mbi hartimin ose jo të projektit ekzekutiv për Kontratën Kornizë për punë.

Rreziku

Hyrja në obligime pa fonde të zotuar rritë rrezikun që projektet të mos financohet në tërësi dhe mund të rezultojë në dështim të kryerjes së tyre. Gjithashtu, zotimet e pjesshëm vështirosjen pagesat me kohë dhe rritet niveli i rrezikut i përpalljes me padi dhe krijohen shpenzime shtesë për shkak të vonesave të mundshme. Po ashtu zhvillimi i procedurave të prokurimit pa një projekt të hartuar paraprakisht mund të ndikoj që punimet e zbatuara në këto projekte të devijojnë nga kërkesat standarde të ndërtimit dhe të mos arrijnë cilësinë e duhur.

Rekomandimi C3 Kryetari të siguroj që kontrollet janë funksionale dhe zyra e prokurimit nuk duhet të nënshkruaj asnjë kontratë publike pa zotim të mjeteve apo ndërmerr obligim në një shumë që i tejkalon fondet e ndara. Gjithashtu, duhet të sigurojë që hartimi i projekteve ekzekutive të realizohet konform kërkesave ligjore para inicimit të procedurave të prokurimit për punë, në të kundërtën nuk mund të fillon tenderimi i ekzekutimit të projekteve.

Çështja A12- Mungesa e dëshmive gjatë vlerësimit të kriterëve për dhënien e shtëpive për familjet skamnore

Gjetja

Sipas Ligjit Nr. 03/L-164 dhe Udhëzimit Administrativ Nr21/2010 për përcaktimin e radhës së përparësisë për kategoritë e familjeve që mund të përfitojnë nga programet e veçanta të banimit, përkatësisht nenit 5 të këtij udhëzimi “Kriteret për përcaktimin e radhës së përparësisë për sigurimin e banimit janë: statusi i banimit, lartësia e të ardhurave, gjendja shëndetësore, invaliditeti, struktura e familjes.

Nga auditimi i pagesave për qëllime të pajtueshmërisë, në një rast komisioni gjatë procedurave të vlerësimit të kriterëve përkatësisht poentimit të aplikacioneve nuk kishte kërkuar/pranuar dëshmi mbi përmbushjen e kriterëve përkatëse për të cilat ishin poentuar aplikacionet dhe ishte bërë përzgjedhja e përfituesve nga programi në fjalë. Shkaku i një dukurie të tillë sipas zyrtarëve përgjegjës ishte mungesa e informacionit mbi dokumentimin e kriterëve përkatëse për të cilat është bërë poentimi dhe përzgjedhja e fituesve.

Rreziku Vlerësimi dhe përzgjedhja e përfituesve në mungesë të dëshmive mbi përmbushjen e kriterëve rrit rrezikun që të njëjtit të mos paraqitnin gjendjen reale për të cilin ishin përzgjedhur përfituesit gjithashtu e njëjta cenon parimin e radhës dhe përparësisë si dhe dëmtimin e reputacionit të komunës.

Rekomandimi A12 Kryetari i Komunës të siguroj kontrole të shtuara që gjatë vlerësimit të aplikacioneve për programet e veçanta të banimit, procesi i poentimit të kriterëve të vendosura duhet të mbështetet me dëshmi përkatëse.

Çështja A13-Mos-vazhdimi i sigurisë së ekzekutimit krahas periudhës së zbatimit të kontratës

Gjetja Te kontrata “Ndërtimi i objektit të ri shkollor (9 klasa) “Ekrem Rexha” në Gërnqare të Prizrenit” përkatësisht pika 1.18 e kushteve të veçanta ndër të tjerash specifikon se siguria e ekzekutimit të kontratës është 10% e vlerës së kontratës. Zyra e prokurimit nuk kishte kërkuar vazhdimin e sigurimit të ekzekutimit të kontratës krahas periudhës sa kontrata është aktive. Data e nënshkrimit të kontratës ka qenë me datën 11/03/2015 me kohë zgjatje prej 120 ditë pune, aq ka qenë edhe afati i sigurimit. Ndërsa nga kjo periudhë nuk posedon asnjë dëshmi mbi vazhdimin e sigurimit të ekzekutimit edhe pse punimet ende nuk janë përfunduar. Komuna ka vazhduar sigurimin e ekzekutimit të kontratës pas identifikimit të auditorit, me datën 01/04/2019 me një vlefshmëri kohore të siguri deri me 30/06/2019.

Rreziku Shkaku i një dukurie të tillë ishte neglizhenca nga zyrtarët përkatës për të ripërtëri sigurimin e ekzekutimit në kontratën përkatëse. Implementimi i kontratës në mungesë të sigurisë së ekzekutimit përveç që është shkelje e kriterëve kontraktuale e njëjta rrit rrezikun që projekti të mos ketë mbulesë për humbjet eventuale gjatë fazës së implementimit të projektit e në rast kontesti rritet rrezikun e përmbushjes dhe kryerjes së punimeve në sasi dhe cilësi sipas kontratës.

Rekomandimi A13 Kryetari të zhvillojë politika dhe procedura për t’u siguruar që realizimi i projekteve përmbushët brenda kornizës kohore të përcaktuar në kontratën përkatëse dhe të garantohen me sigurim të ekzekutimit gjatë tërë periudhës të përfundimit të punimeve në bazë të marrëveshjes kontraktuale, duke eliminuar edhe mundësin e kontraktimit pa fonde të mjaftueshme si dhe pengesat tjera gjatë ekzekutimit të punimeve.

Çështja A14 - Vonesat në ekzekutimin e kontratave

Gjetja Te kontrata “Ndërtimi i kanalizimit dhe rrugëve në Hoqë të qytetit të Prizrenit” në vlerë prej 106,965€ nënshkruar në vitin 2017, ndër të tjerash pika 1.18 e kushteve të veçanta plani dinamik i përfundimit të punimeve

specifikohet së ditët për realizimi të punimeve duhet të jetë prej 200 ditë pune, ndërsa të ekzekutuara deri në pranimin teknik të punimeve ishin 289 ditë pune. Sipas mbikëqyrësit të kontratës, shkak i vonesave ishte mungesa e mjeteve në dispozicion për të përfunduar kontratën. Gjithashtu, si shkaktarë janë evidentuar edhe disa raste të kontesteve pronësore në teren përgjatë realizimit të projektit.

Rreziku

Planifikimi jo u duhur i mjeteve dhe mos eliminimi me kohë i pengesave të kontesteve pronësore ka rezultuar me vonesa në përfundimin e projekteve bazuar në planin dinamik. Vonesat e tilla mund të vendosin komunën përball drejtësisë për shkak të mosrespektimit të kontratës dhe ekzekutimit të obligimeve me kohë ndaj kontraktueseve, dhe mos shfrytëzimin e përfitimeve të parapara të qytetarëve nga shërbimet që ato ofrojnë.

Rekomandimi A14 Kryetari të sigurojë kontrolle më të fuqishme në mbikëqyrjen e realizimit të projekteve në mënyrë që ato të përfundohen sipas planit dinamik dhe pengesat si mungesa e mjeteve dhe problemet pronësorë janë eliminuar para hyrjes në kontratë. Aty ku vonesat janë rezultat i kontraktuesit të zbatohen masat ndëshkuese sipas kushteve të përcaktuara në kontratë, në mënyrë që të rritet përgjegjësia tek operatorët ekonomik.

3.1.6 Çështjet e përbashkëta për mallrat dhe shërbimet si dhe investimet kapitale

Çështje për vëmendje mbeten pagesat të ekzekutuara sipas vendimeve gjyqësore dhe dispozitave sipas nenit 39.2 të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (LMFPP).

Çështja B6 - Pagesat e gjobave si pasojë e vonesave në kryerjen e obligimeve

LMFPP neni 39.2 dhe neni 40 rregullon pagesën e faturave nga thesari, përmbaruesit dhe vendimet gjyqësore. Nga 100 pagesat në vlerë prej 2,508,733€ të kryera direkt nga thesari në bazë të vendimeve gjyqësore dhe përmbaruesit privat, vetëm për shpenzimet administrative dhe shpenzime tjera përmbarimore janë paguar 43,466€. Një ndër arsytet e një dukurie të tillë ishte lidhja e kontratave me operatorët ende pa u siguruar fondet e nevojshme. Por një shkak tjetër ishte edhe neglizhencës nga ana e zyrtareve përgjegjës komunal, pasi që në disa raste ekzistonin mundësitë buxhetore/mjetet për pagesën e faturave brenda afatit ligjor. Për më tepër suficiti apo mjetet e lira nga investime kapitale ishin prej 2,792,308€, mjete të cilat komuna ka mund të shfrytëzojë për pagesën e obligimeve.

Rreziku Hyrja në obligime pa fonde të zotuara, neglizhenca e pagesave në afatin ligjor rritë rrezikun që të mos mund të financohen në tërësi projektet dhe të rezultojë me dështim të kryerjes së tyre, gjithashtu rritet niveli i rrezikut se mund të krijohen shpenzime të interesave e gjobave për vonesat në pagesa.

Rekomandimi B6 Kryetari i Komunës duhet të rrisë kontrollet në menaxhimin e projekteve. Fillimisht duhet të sigurohen fondet e nevojshme si dhe të gjitha parakushtet tjera për fillimin e projekteve, e më pas të zhvillohen procedurat tjera për kontraktimin me OE. Me tutje, të sigurojë kontrolle në monitorimin e pagesave të faturave në afatin ligjor deri në procesin e ekzekutimit të pagesave.

Çështja A15- Mungesë komunikimi dhe informimi me rastin e pagesave nga Thesari

Gjetja Në përputhje me LMFP neni 39, thesari ka pagatitur “Procedurën për trajtimin e kërkesave të furnitorëve për obligimet e vonuara dhe papaguara sipas nenit 39.2”, ku pjesa 5 e kësaj procedure kërkon që për çdo pagës të realizohet komunikim përmes shkresës përcjellëse të nënshkruar e cila dërgohet përmes postes elektronike të organizata buxhetore e cila duhet të kundërshtoj ose konfirmoj. Kësaj kërkesës standarde për konfirmim/kundërshtim të organizatës buxhetore duhet t’i bashkëngjiten edhe kopjet e dokumentacion të prezantuar nga furnitori bashkë me kërkesën (e-mail), për të siguruar dhe konfirmuar vërtetësinë e dokumentacionit në fjalë.

Kemi identifikuar se 11 pagesa në shume prej 181,164€ ishin ekzekutuar nga thesari pa komunikuar dhe pa e informuar komunën. Për me tepërnë një rast pagesa e datës 10/7/2018 në vlerë prej 19,306€ ishte bërë përmbaruesit privat direkt nga thesari në mbështetje të nenit 39.2, kurse sipas dokumentacionit/ dëshmime për pagesë, mjetet janë shpenzuar edhe pse obligimi ndaj këtij furnitorit nuk i takonte Komunës së Prizrenit. Komuna nuk kishte vërejt gabimin dhe kjo pagesë figuronte në regjistrin e shpenzimeve, deri sa pagesa e tillë është korrigjuar pas informimit nga ana e ekipit të auditimit. Me këtë rast edhe zyrtarët e thesarit pastaj kanë konfirmuar se gabimisht është ekzekutuar kjo pagës. Shkaku i dukurivëtë tilla është pa përgjegjësia e thesarit, në mungesë të komunikimit të rregullt me organizatën buxhetore me rastin e ekzekutimit të pagesave.

Rreziku Mungesa e komunikimit rrit rrezikun e ekzekutimit të pagesave nga thesari për obligimin që nuk i përket organizatës buxhetore/komunës dhe dëmton buxhetin komunal.

Rekomandimi A15 Kryetari të siguroj që marrëveshjet e nënshkruara me donatorë dhe operator të implementohen në tërësi dhe të mos ketë vonesa në kryerjen e obligimeve kontraktuale. Të vendosen kontrole që parandalojnë gabimet e tilla dhe të sigurohet se për çdo gabim/lëshim nga organizatat varëse komuna e identifikon dhe reagon me kohë. Gjithashtu, të ndërmerren masa për vendosjen e komunikim me thesarin dhe informimin me kohë për pagesat që ekzekutohen nga thesari.

3.2 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Vlera e pasurisë kapitale e paraqitur në PFV-të pasuri mbi 1,000€ është në vlerë prej 481,551,000€ kurse pasuria nën 1,000€ në vlerë prej ishte 1,052,000€. Ne kemi rishikuar nëse procesi i mbajtjes së regjistrave është në pajtueshmëri me kërkesat e rregullores MF-Nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore, procesin e inventarizimit dhe ekzistencën fizike të pasurive. Çështjet domethënëse rreth pasurisë janë trajtuar në seksionin 2.1.

Çështja B7 - Mangësi në inventarizimin dhe evidentimin e pasurisë dhe mungesë e procedurës së brendshme

Gjetja Neni 19.4 i Rregullores 02/2013 për Menaxhimin e pasurisë jo financiare thekson se përgjegjësitë e komisionit për inventarizim ndër të tjera janë “Inventarizimi i të gjithë pasurisë jo financiare që është në pronësi dhe në kontroll të organizatës buxhetore”. Po ashtu tek neni 13 paragrafi 4.7 përcakton se “Hartimi i raportit të përgjithshëm në bazë të raporteve individuale të Komisionit për Inventarizimin e Pasurisë jo Financiare duhet përgatitur në kohën e përshtatshme para përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore. Kurse paragrafi 4 i nenit 13 përcaktona se “Të gjitha ndryshimet në numrin ose vlerën e pasurive të cilat përcaktohen pas inventarizimit duhet të pasqyrohen në regjistrin e pasurive dhe në regjistrin kontabël”;

Neni 4.1 i Rregullores 02/2013 për Menaxhimin e pasurisë financiare thekson se "Zyrtari Kryesor Administrativ është përgjegjës për aprovimin e rregullave dhe procedurave të brendshme për evidencën, ruajtjen dhe tjetërsimin e pasurisë jo financiare".

Raporti i komisionit për inventarizimin e pasurisë ishte i mangët, dhe nuk ishte përfunduar me kohë, para përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore. Komisioni për inventarizim kishte përfunduar dhe dorëzuar raportin me datën 26.02.2019 që nuk ishte sipas kërkesave të rregullores për menaxhimin e pasurisë dhe;

Përkundër që komisioni i inventarizimit kishte identifikuar pasuri të dëmtuar si dhe pasuri me vlerë zero, komuna nuk ka ofruar dëshmi se është formuar një komision për të vlerësuar nëse ato duhet të largohen nga përdorimi ose të tjetërsohen, ashtu siç kërkohet me Rregulloren MF- nr. 02/2013 si dhe;

Regjistri i E-pasurisë nuk është i saktë për arsye se blerjet nga sektori i QKMF-së, Mirëqenies Sociale dhe Drejtoria e Arsimit nuk regjistrohen në këtë softuer, siç është paraparë në nenin 6, të rregullores 02/2013 për menaxhimin e pasurive financiare si dhe

Komuna edhe gjatë këtij viti nuk ka aprovuar asnjë rregullore për procedura të brendshme për menaxhimin e pasurisë, përkundër që ishte rekomandim në raportin e vitit të kaluar.

Rreziku

Mos realizimi i plotë i inventarizimit të pasurisë siç kërkohet me rregullore, mund të rezultojë që komuna të mos identifikoj gjendjen reale dhe faktike të pasurive të cilat mund ti ekspozohen humbjes apo tjetërsimit. Mangësitë në regjistrimin e plotë të pasurisë duke mos përfshirë të gjitha blerjet, vështirësojnë identifikimin e pasurive për të konfirmuar ekzistencën, prejardhjen dhe pronësinë e tyre. Kjo rezulton edhe me nënvlerësim të pasurive të prezantimit dhe shpalosura në PFV. Po ashtu Mungesa e procedurave të brendshme për ruajtjen dhe tjetërsimin e pasurisë mund të ndikoj që pasuria e komunës mos të menaxhohet si duhet dhe mos të prezantohet drejtë në pasqyrat financiare.

Rekomandimi B7 Kryetari duhet të sigurojë se procesi gjithë përfshirës i regjistrimit të pasurive duhet të përfundoj me kohë dhe vazhdoj me vlerësimin e pasurisë brenda një afati optimal dhe pas përfundimit të procesit të përgatit një raport përfundimtar mbi gjendjen e pasurive, të cilin duhet ta harmonizoj me regjistrat kontabël të komunës. Diferencat e shfaqura duhet të sqarohen dhe regjistrat duhet të azhurnohen sipas të dhënave të regjistrimeve të fundit. Kërkesat në lidhje me regjistrimin dhe mirëmbajtjen e pasurive duhet të aplikohen në tërësi, përmes sistemit E- pasuria të evidentohen të gjitha hyrjet/daljet e pasurive të luajtshme (me vlera nën 1,000€) për të gjitha dikasteret komunale. Gjithashtu, duhet të siguroj hartimin e rregullave dhe procedurave të brendshme për evidencën, ruajtjen dhe tjetërsimin e pasurisë jo financiare sipas kërkesës së rregullores 02/2013.

3.3 Trajtimi i parasë së gatshme dhe ekuivalentëve të saj

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.4 Të arkëtueshmet

Lista e debitorëve ndaj komunës, sipas të dhënave në PFV është 18,932,000€. Pjesa më e madhe e tyre kanë të bëjnë me llogarit e arkëtueshme për tatimin në pronë, (8,089,000€), taksa në firmë (6,818,000€), mbeturinat (2,955,000€), tregjet (252,000€), lokalet (532,000€) etj. Çështjet domethënëse rreth kësaj llogarie janë trajtuar në seksionin 2.1.

Çështja B8 - Niveli i lartë i të arkëtueshmeve

Gjetja Edhe pse komuna përballlet me vlerën e lartë të llogarive të pa arkëtuar dhe rritjen e tyre nga viti në vit (nga 17.063 milion në 2017, në 18.932 milion në 2018), ende nuk ishte hartuar apo aplikuar ndonjë politikë adekuate në mbledhjen e të arkëtueshmeve nga vitet paraprake, në veçanti nga tatiminë pronë, taksat në firmë, të hyrat nga mbeturinat si dhe borxhet nga qiraja. Rritje e borxhit ndaj komunës është evident edhe tek të hyrat e pa arkëtuar për mbledhjen e mbeturinave që krahasuar me vitin 2017 kjo llogari është rritur për 614,000€. Faturimi i 8,000 amvisëri të cilat nuk paguajnë, dhe borxhi vlerësohet të jetë 432,000€¹², ka ndikuar direkt në rritjen e kësaj llogari të pa arkëtuar.

¹² 8,000 amvisëri *54 tarifa vjetore.

Shkaku i rritjes së llogarive është mos vendosja e mekanizmave adekuatë nga ana e komunës për t'i arkëtuar këto të hyra. Përpos aplikimit të vërejtjeve si masë e përdorur nga komuna, mungonin veprime të vazhdueshme si inicimi i procedurave për arkëtim të detyrueshëm të borxheve nëpërmes organeve tjera kompetent.

Rreziku Mungesa e mekanizmave ka rezultuar me vlerë të lartë e të arkëtueshmeve që rrisin rrezikun e vjetërsimit të këtyre llogarive si të pa mbledhshëm me kohë si dhe reflektojnë në mos përmbushjen e planit të shpenzimeve.

Rekomandimi B8 Kryetari duhet të siguroj që po shqyrtohen në mënyrë aktive të gjitha opsionet e mundshme, duke vendosur politika, rregullore dhe mekanizma tjerë me qëllim të rritjes së efikasitetit në mbledhjen e të arkëtueshmeve. Po ashtu duhet shqyrtuar të gjitha masat në pajtim me ligjin, ndaj operatorëve të cilët nuk i përmbushin obligimet kontraktuale.

3.5 Obligimet e papaguara

Pasqyra e detyrimeve të papaguara ndaj furnitorëve nga 3,294,000€ sa ishin në fund të vitit 2017 kanë shënuar rënie në vlerë prej 2,228,685€. Këto detyrime janë bartur për t'u paguar në vitin 2019. Kjo vlerë e obligimeve të papaguara është rezultat i kontrolleve të brendshme të pamjaftueshme dhe hyrjes në obligime pa mjete të mjaftueshme. Komuna përballet edhe me detyrime kontingjente ku në PFV janë prezantuar në vlerë prej 4,130,000€. Çështjet domethënëse rreth obligimeve janë trajtuar në seksionin 2.1.

Çështja B9 - Niveli i lartë i obligimeve

Gjetja Sipas Rregullës Financiare 01-2013 MF- Shpenzimi i parave publike OB duhet që çdo faturë të vlefshme për pagimin e mallrave dhe shërbimeve të pranuar të paguaj brenda 30 ditësh kalendarike nga data e pranimit të faturës. Për më tepër, kemi identifikuar se pagesat e bëra gjatë vitit 2018 që e kanë tejkaluar afatin ligjor për pagesë ishin në vlerë prej 5,835,202€. Shkaku i kësaj dukurie ishte hyrja në obligime pa fonde të mjaftueshme, mos planifikim i pagave jubilarë dhe mos funksionimi i kontrolleve të brendshëm.

Rreziku Si pasojë e vonesave të pagesave dhe mungesës së informacioneve të plota mund të dobësohet aftësia e komunës për të parashikuar dhe menaxhuar nevojat për likuiditet. Po ashtu, komuna mund të përballet me kosto shtesë të interesave e gjobave për vonesat në pagesa.

Rekomandimi B9 Kryetari duhet të forcojë kontrollet në procesin e menaxhimit të pagesave për të siguruar që komuna mos të hyjë në obligime pa fonde të mjaftueshme, që të gjitha faturat paguhen brenda afatit ligjor. Po ashtu të sigurojë se raportimi i obligimeve bëhet për çdo muaj në përputhje me kërkesat ligjore e cila duhet të përfshijë gjendjen e saktë të tyre.

4 Qeverisja e mirë

Qeverisja e mirë nënkupton parimet themelore të llogaridhënies, efektivitetin e kontrolleve, menaxhimin e rreziqeve, pavarësinë e auditimit të brendshëm, koordinimin e ZKA me auditimin e brendshëm dhe qeverisjen e mirë me pasuritë publike.

Tregues kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit pasi kjo tregon se në çfarë mase menaxhmenti po ndërmerr veprime për t'i përmirësuar proceset ekzistuese dhe kontrollet. Niveli i përmbushjes së kërkesave të MFK nga ana e organizatave buxhetore po monitorohet edhe nga plotësimi i listave kontrolluese të vlerësimit që plotësohet nga të gjitha OB-të, të cilat në fund të vitit i dorëzohen Ministrisë së Financave.

Fusha të veçanta të rishikimeve tona lidhur me qeverisjen kanë qenë procesi i llogaridhënies dhe menaxhimi i rreziqeve, ndërsa komponentët tjera janë trajtuar në brendi të kapitujve apo nënkapitujve të mësipërm të raportit.

Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

Ne kemi vlerësuar disa aktivitete që mund t'i kontribuojnë një qeverisje të mirë, si dhe mundësitë ekzistuese për përmirësim të mëtejshëm si në vijim:

Adresimi i plotë dhe cilësor i rekomandimeve tona si dhe çështjet e ngritura të pajtueshmërisë mbesin ende sfidë për Komunën e Prizrenit. Një progres në menaxhimin e organizatës, kryesisht në arkëtimin e të hyrave, në shlyerjen e borxheve të prapambetura, si dhe veprime të konsiderueshme janë ndërmarrë në ndërtimin e marrëdhënieve kontraktuale me donatorë të ndryshëm. Për shumicën e aktiviteteve komunale ka një komunikim dhe raportim mes bartësve të njësive dhe kryetarit, por mungon procesverbalet e takimeve si dhe monitorimi strategjik, si dhe nuk ka një raportim formal dhe sistematik (monitorim) që i ndërlidh objektivat e komunës me rezultatet.

Ekziston një numër i dobësive në sistemin qeverisës të komunës, veçanërisht në lidhje me llogaridhënien, menaxhimin e rrezikut dhe cilësinë e raportimit menaxherial. Pyetësi i vlerësimit i plotësuar nga komuna, e pasqyron këtë situatë vetëm pjesërisht, me disa komente pozitive mbi ekzistimin e aranzhimeve ekzistuese që nuk bazohen në dëshmi.

Mjet kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të dhëna nga auditimi i jashtëm. Përgjigja efektive ndaj zbatimit të rekomandimeve nuk është e kënaqshme. Për më shumë kjo pjesë është trajtuar më tek kapitulli 'Progresi i zbatimit të rekomandimeve'.

Fushat kryesore ku nevojiten më shumë përmirësime janë: Regjistrimi i pasurive komunale, menaxhimit të pronave komunale, menaxhimi i të arkëtushmeve ku edhe me tej nuk ishte formuar një komision i veçantë për të identifikuar kontestet me prona dhe shfrytëzimin e lokaleve në veçanti të tregjeve të cilët debitorët ende nuk i kryen obligimet ndaj komunës. Sipas verifikimit, shumica nga lokalet afariste nuk kanë kontrata valide për shfrytëzimin e tyre, pasi që kontratatave ju kishte skaduar afati në vitin 2013, për me shumë shfrytëzimin e tyre nga persona të ndryshëm pa ndonjë bazë ligjore, krijon humbjen e mundësisë për faturim nga ana e komunës.

Komuna edhe pse kishte formuar ekipin për hartimin e planit strategjik edhe me tej nuk kishte arritur për të hartuar planin strategjik dhe nuk kishte hartuar listën e rreziqeve me të cilën mund të ballafaqohet. Po ashtu ende mungonin planet tjera strategjike si: planet hapësinore, plani strategjik kundër korrupsionit, strategjia e zhvillimit rajonal etj.

4.1 Sistemi i auditimit të brendshëm

Për të kryer një auditim efektiv nevojitet një program gjithëpërfshirës i punës që reflekton rreziqet financiare dhe të tjera të entitetit të audituar dhe që ofron siguri të mjaftueshme mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm. Ndikimi i raporteve të Auditimit të Brendshëm duhet të gjykohet nga rëndësia që i jep menaxhmenti adresimit të rekomandimeve si dhe nga mbështetja e ofruar nga një Komitet efektiv i Auditimit. Njësia e Auditimit të Brendshëm (NjAB) operon me një anëtarë dhe atë vetëm- Drejtori i NjAB. Marrë parasysh buxhetin e komunës, sipas kërkesave UA. 23/2009 për themelimin dhe funksionimin e NjAB-së, përbërja e kapaciteteve të kësaj njësie me vetëm një auditor, nuk është e mjaftueshme, më gjithëkërkesën në vazhdimësi dhe njoftimi me rastin e raportimit në Njësinë harmonizuese për staf të limituar nga ana e kësaj njësie.

Përveç planit strategjik kjo njësi kishte hartuar edhe planin vjetor të punës sipas të cilit ka planifikuar tetë auditime, ku për periudhën raportuese për vitin 2018 kishte përfunduar dhe finalizuar gjashtë raporte sipas planit, një raport ka finalizuar me kërkesën e menaxhmentit, kishte bërë një rishikim për të verifikuar adresimin e rekomandimeve, si dhe një rishikim të implementimit të rekomandimeve të dhëna nga ZKA, në bashkëpunim me USAID-in.

Çështja C4 - Mos adresimi i rekomandimeve të NJAB

Gjetja NJAB kishte dhënë rekomandime se si menaxhmenti të përmirësojë funksionimin e kontrollit të brendshëm. Sipas Planit të veprimit të përgatitur për 2018, nga 24 rekomandime e dhëna, nëntë ishin zbatuar, 12 ishin në proces të zbatimit, ndërsa tri nuk ishin zbatuar ende. Për me tepër zbatimi i rekomandimeve të dhëna edhe për vitin 2017 nuk ishte në nivelin e duhur. Nga 23 rekomandime, vetëm pesë janë zbatuar dhe nëntë ishin në proces të zbatimit, ndërsa tjerat nuk ishin zbatuar.

Komiteti i Auditimit gjatë këtij viti ka mbajtur tri takime me NjAB, por edhe më tej ndikimi i komitetit nuk është vërejtur përmirësim të aktiviteteve të menaxhmentit të komunës në adresimin e rekomandimeve.

Rreziku Stafi i limituar në NJAB, do të rezultojë në mos funksionimi adekuat i sistemit të auditimit të brendshëm, zvogëlon sigurinë që i ofrohet menaxhmentit në lidhje me funksionimin e sistemeve kyçe financiare, sidomos në një ambient organizativ si Komuna e Prizrenit, ku ka një numër të shkollave, institucioneve vartëse apo edhe njësisive tjera të cilat krijojnë të hyra dhe shpenzime të cilat do të duhej t'i nënshtroheshin një numri auditimesh të kohëpaskohshme. Kjo mund të rezultojë me dobësi të paidentifikuara dhe me vazhdimin e praktikave joefektive dhe do të zvogëlojë mundësinë që ZKA të marrë siguri nga puna e NjAB, përkundër punës voluminoze dhe cilësore të ndërmarrë nga kjo njësi; dhe

Po ashtu dështimi për të adresuar rekomandimet e auditimit të brendshëm mund të rezultojë me vazhdimin e dobësive të identifikuara, jo efikasitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm, humbje financiare për komunën dhe vlerë të dobët për para.

Rekomandimi C4 Për të arritur përfitimin maksimal nga shërbimet e auditimit të brendshëm, Kryetari duhet të sigurojë se do të plotësohet me personel të mjaftueshëm NjAB, si dhe të rishikojë arsyet për veprimet e limituara të ndërmarrë në lidhje me rekomandimet. Gjithashtu, duhet të ndermirren veprime shtesë për funksionalizimin e KA-të në mënyrë që të sigurojë mbikëqyrjen, ngritjen dhe fuqizimin e rolit të auditimit të brendshëm.

4.2 Raportimi menaxherial, llogaridhënia dhe menaxhimi i rrezikut

Për të pasur një planifikim të mirë, për të mbikëqyrë aktivitetet në baza të rregullta dhe për të mundësuar vendimmarrje efektive, menaxhmenti ka nevojë të posedoj raporte të rregullta. Llogaridhënia si proces është pranim i përgjegjësive, mbajtje e personave përgjegjës për veprimet e tyre dhe shpalosje e rezultateve në mënyrë transparente. Ndërsa, menaxhimi i rrezikut është një proces që ka të bëjë me identifikimin, analizën vlerësimin dhe veprimet/masat e menaxhmentit për të kontrolluar dhe reaguar ndaj rreziqeve që kërcënojnë organizatën.

Menaxhmenti, ndonëse ka zbatuar një numër kontrollesh të brendshme për të siguruar se sistemet funksionojnë si duhet, kemi vërejtur se masat e aplikuara janë edhe më tej jo efektive dhe nuk mundësojnë një përgjigje adekuate dhe me kohë ndaj problemeve operative të identifikuara.

Çështja B10 – Dobësi në kontrollet menaxheriale dhe menaxhimin e rrezikut

Gjetja Rishikimi ynë i kontrolleve menaxheriale të zbatuara në sistemin kryesor financiar të komunës ka nxjerrë në pah një raportim jo efektiv financiar mbi shpenzimet dhe të hyrat tek menaxhmenti i lartë si dhe analiza të pakompletuara. Përkundër që është deklaruar për raportim mujor, komuna nuk ka ofruar raportet të cilat drejtoritë dorëzojnë tek menaxhmenti i lartë për të rishikuar nëse është adresuar rekomandimi i vitit paraprak. Si të tilla aranzhimet e përgjithshme të qeverisjes, kërkojnë përmirësim. Kemi identifikuar se kontrollet mbi të hyrat akoma nuk janë mjaft efektive, dhe ka mangësi në kontrolle në disa fusha të shpenzimeve në veçanti niveli i ekzekutimit të buxhetit nga kategoria e investimeve Komuna gjithashtu edhe gjatë vitit 2018 nuk ka politika të shkruara dhe procedura për menaxhimin e rreziqeve, në veçanti rrezikut të mashtrimit dhe parregullsive.

Rreziku Mos azhurnimi i raportimit financiar dhe të aktiviteteve tek menaxhmenti i lartë redukton aftësinë e menaxhmentit për të menaxhuar aktivitetet e komunës në mënyrë pro aktive si dhe ulë efektin e kontrolleve buxhetore. Kjo, gjithashtu, mund të ndikoj që të hyrat të mos arkëtohen siç pritet. Ngjashëm, mund të rezultojë në ofrimin e shërbimeve të dobëta. Mungesa e raportimeve nga bartësit e njësive administrative reduktojnë efektivitetin e menaxhimit financiar brenda komunës, duke rezultuar me dobësi në procesin buxhetor si dhe në reduktimin e mundësisë që menaxhmenti të reagojë ndaj sfidave financiare me kohë. Ato gjithashtu rrisin rrezikun për shpenzime të parregullta.

Rekomandimi B10 Kryetari duhet të siguroj se është kryer një rishikim për të përcaktuar formën e raportimit financiar dhe operativ tek menaxhmenti i lartë, nga i cili mund të nxirren të gjitha informatat relevante që ndikojnë në vendimmarrjen cilësore dhe me kohë të menaxhmentit. Ecuritë buxhetore, duke përfshirë të hyrat dhe shpenzimet, dhe zbatimin e planit të prokurimit duhet të jenë subjekt i raportimeve dhe rishikimeve të rregullta nga ana e menaxhmentit.

5 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti ynë i auditimit për PFV-të të vitit 2017 të Komuna e Prizrenit ka rezultuar në 20 rekomandime kryesore. Komuna kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna. Më tutje, komuna nuk kishte ndjekur ndonjë proces formal për të monitoruar zbatimin e rekomandimeve dhe ndërmarrjen e veprimeve të nevojshme për zbatimin e tyre. Kjo ka ndikuar që vetëm një pjesë e rekomandimeve të zbatohen dhe të përsëriten mangësitë e njëjta në disa fusha. Ansamble ja Komunale e Prizrenit me 31 Korrik 2018 ka shqyrtuar dhe është diskutuar në lidhje me raportin e auditimit të ZKA-së për vitin 2017. Përkundër angazhimeve të potencuar, pjesa më e madhe e rekomandimeve kanë mbetur të pazbatuar ose në proces të zbatimit.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2018, pesë (5) rekomandime janë zbatuar, katër (4) ishin në proces dhjetë (10) nuk janë zbatuar ende dhe një (1) është mbyllur i pa zbatuar. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 4 (ose Tabelën e rekomandimeve)

Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitit 2018

Nr.	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2017	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1	PFV	Kryetari duhet të sigurojë që është bërë një analizë për të përcaktuar arsyet për theksim të çështjes. Duhet të ndërmerren veprime për të adresuar dobësitë e rëndësishme në një mënyrë sistematike dhe pragmatike për të zbutur dobësitë e shpalosura në theksimin e çështjes të opinionit të auditimit. Gjithashtu, kryetari duhet të sigurojë se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që plani i hartimit të PFV 2018i adreson të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me pajtueshmërinë. Kjo gjithashtu duhet të përfshijë rishikimin e draft PFV-ve nga menaxhmenti, me fokus të veçantë në fushat me rrezik të lartë dhe/ose fushat ku janë identifikuar gabime në vitet e mëparshme. Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, nuk duhet të dorëzohet përveç nëse ndaj draft PFV-të janë aplikuar të gjitha kontrollet e nevojshme.	Janë marrë veprime konkrete komuna ka arritur të bëjë buxhetimin e mbeturinave nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve por jo edhe regjistrimin e E-pasurisë në drejtorin e shëndetësisë, mërqnijës sociale dhe drejtorin e Arsimit.	Pjesërisht i zbatuar.
2	Realizimi i buxhetit	Kryetari duhet të sigurojë që performanca buxhetore është monitoruar në mënyrë sistematike në baza mujore dhe që ky rishikim i identifikon dhe adreson barrierat për realizim të buxhetit në nivel të planifikuar. Aty ku supozimet e buxhetit fillestar janë të pasakta, kjo duhet të reflektohet plotësisht në pozitën e buxhetit final.	Komuna ka treguar dobësi në ekzekutimin e buxhetit për investime kapitale edhe këtë vit.	Nuk është zbatuar.
3	Të hyrat	Kryetari duhet të sigurojë se verifikimi të bëhet në baza të rregullta vjetore sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, që reflekton shënime të përditësuara të regjistrit dhe ngarkesave të sakta tatimore.	Gjatë testimeve dhe analizës së data bazës, si dhe ndryshimit të ligjit në Tatimin në pronë, janë ndërmarr veprimet e nevojshme.	Është zbatuar.

4	Parregullsi i në dhënien me qira të pronave komunale	Kryetari duhet të shqyrtoj arsyet e gjendjes ekzistuese dhe të vendos masat e duhura që brenda një periudhe të arsyeshme të inkasoj të gjitha të arkëtueshmet e prapambetura, ose në të kundërtën, të ndaloj shfrytëzimin e pronave publike pronarëve, të cilët nuk i kanë kryer obligimet ndaj komunës, të siguroj që për të gjitha pronat publike të organizohet ankandi publik dhe të nënshkruhen kontratat sipas legjislacionit.	Edhe gjatë këtij viti nuk janë vendosur kontrollet efektive për arkëtimin e të hyrave. Po ashtu edhe gjatë këtij viti kemi vërejtur parregullsi në ngarkesat tatimore.	Nuk është zbatuar.
5	Parregullsi i në kalkulimin e të hyrave për tatimin në prone dhe të hyrave tjera	Kryetari duhet të siguroj se ngarkesa për pagesën e obligimeve të qytetarëve është duke u bërë sipas rregullores për taksa, tarifa, ngarkesa dhe gjoha nga shërbimet dhe veprimtaritë komunale. Në të kundërtën, rregullorja duhet të ndryshohet dhe plotësohet sipas tarifave të reja.	Përveç masave preventivë, nuk ka aplikuar masa tjera ligjore.	Nuk është zbatuar.
6	Mungesë e dosjeve të personelit	Kryetari të siguroj rishikimin e mundësisë që këta zyrtarë të transferohen në institucionet ku ata punojnë, ose të kompletohen dosjet e tyre në komunë për të krijuar bazë ligjore për ekzekutimin e pagave të tyre. Po ashtu kryetari duhet të sigurojë që listat e pagave nënshkruhen nga të gjithë të punësuarit e komunës.	Komuna ka pasur takime me përfaqësuesit e Drejtorisë përkatëse të MPB, me rastin e përpilimit të planit të zbatimit të rekomandimeve por nuk është arritur ndonjë marrëveshje konkrete.	Nuk është zbatuar.
7	Mungesë e dëshmive për punët jashtë orarit	Kryetari duhet të siguroj që puna jashtë orarit të planifikohet në mënyrë efektive, kompensimet për orë shtesë duhet të konsiderohen vetëm gjatë periudhave kur ka vëllim më të madh të punëve dhe puna shtesë duhet të dokumentohet dhe arsyetohet.	Auditori këtë vit nuk ka vërejt parregullsi në këtë fushë.	Është zbatuar.
8	Parregullsi i në angazhimin e stafit për shërbime të veçanta	Kryetari duhet të sigurojë se punonjësit përmes marrëveshjeve për shërbime të veçanta angazhohen vetëm në rastet kur ka kërkesa specifike. Angazhimi të bëhet në përputhje me kërkesat ligjore përmes një procesi konkurrues dhe transparent dhe periudha e angazhimit të bëhet në kuadër të afateve të parapara me ligj. Ndërsa për të	Edhe gjatë këtij viti angazhimi i zyrtareve me marrëveshje për shërbime të veçanta është mjaftë i theksuar.	Nuk është zbatuar.

		gjitha pozitat e rregullta të punës duhet të sigurohet se buxhetohen nga kategoria e pagave dhe mëditjeve si dhe paguhen nga sistemi i pagave.		
9	Pagesa për mallra, shërbime pa procedura të prokurimit	Kryetari duhet të sigurojë se nuk janë anashkaluar procedurat e prokurimit aty ku janë të zbatueshme si dhe me rastin e përgatitjes së kërkesave për mirëmbajtjen e automjeteve mundësisht të përfshihen të gjitha auto pjesët e nevojshëm.	Komuna ka ndërmarr masat konkrete dhe autori nuk ka identifikuar raste të tilla.	Është zbatuar.
10	Dobësi sistematike në menaxhimin e kontratave për investime kapitale	Kryetari duhet të sigurojë se projektet duhet të realizohen në pajtim me planeve dhe buxhetit. Në rastet kur shfaqet nevoja për ri destinim të mjeteve apo ndryshim të projekteve, duhet të ndiqen procedurat administrative të ri destinimit të mjeteve. Furnizimet dhe kryerja e punimeve duhet të mbikëqyren në vazhdimësi dhe pagesat të bëhen vetëm pasi të merret siguria e plotë se pozicionet e faturuara janë realizuar sipas paramasave dhe parallogarive, si dhe të forcoj masat e kontrollit që dështimet e tilla të mos përsëriten.	Sa përket përfshirjes së projekteve në planin vjetor të prokurimit është zbatuar rekomandimi. Ndërsa edhe gjatë këtij viti kemi vërejtur se janë bërë pagesa për pozicionet e pa përfunduar.	Pjesërisht i zbatuar.
11	Planifikim dhe menaxhim i dobët i kontratave	Kryetari të sigurojë që zyra e prokurimit të mos fillojë procedurat e prokurimit para se të përmbushen kriteret ligjore përkatësisht pa hartuar projektin ekzekutiv si dhe të sigurojë kontrole të shtuara që para nënshkrimit të kontratave të bëhet zotimi i mjeteve. Me tutje të gjitha pagesat duhet të bëhen në përputhje të plotë me kushtet e përcaktuara në kontratë.	Sa i përket hartimit të projekteve përkundër që është marrë masa ende nuk është adresuar në tërësi rekomandimi, gjithashtu pagesat në përputhje me kushtet e kontratës është adresuar (pasi që garancioni i kualiteti të ndërtimit është adresuar).	Pjesërisht i zbatuar.
12.	Pagesat e gjobave i pasojë e vonesave në kryerjen e	Kryetari i Komunës duhet të rrisë kontrollet në menaxhimin e projekteve	Komuna edhe këtë vit vazhdon të këtë të njëjtën gjendje.	Nuk është zbatuar.

	obligimeve	kapitale. Fillimisht duhet të sigurohen fondet e nevojshme si dhe të gjitha parakushtet tjera për fillimin e projekteve, e më pas të zhvillohen procedurat tjera për kontraktimin me OE. Me tutje, të sigurojë kontrolle në monitorimin e punimeve deri në procesin e ekzekutimit të pagesave.		
13	Shmangie nga procedura e rregullta të prokurimit	Kryetari duhet të siguroj se kontrollet e vendosura janë funksionale gjatë vlerësimit dhe përzgjedhjes së operatorëve, aty ku ekziston mundësia të shqyrtoj në detaje rastet dhe të kërkojë sqarime shtesë. Me tutje të kërkojë një planifikim të hollësishëm dhe njësitë të vlerësojnë në mënyrë të drejtë kërkesat për prokurim, si dhe të respektohen në plotësi LPP si dhe UA, në mënyrë që rastet e mësipërme të mos përsëriten.	Rekomandimet përkatëse janë adresuar.	Është zbatuar.
14	Dobësi në regjistrimin e pasurisë nën 1,000€- E-pasuria	Kryetari duhet të siguroj hartimin e rregullave dhe procedurave të brendshme për evidencën, ruajtjen dhe tjetërsimin e pasurisë jo financiare sipas kërkesës së rregullore 02/2013, si dhe të sigurojë se procesi gjithë përfshirës i regjistrimit të pasurive do të vazhdoj dhe brenda një afati optimal do të nxirret një regjistër përfundimtar mbi pasuritë e komunës. Po ashtu të gjitha hyrjet/daljet e pasurive të luajtshme me vlera nën 1,000€ të bëhen përmes sistemit e-pasuria në të gjitha dikasteret komunale.	Komuna edhe këtë vit vazhdon të ketë të njëjtën gjendje, sistemi i e-pasurisë nuk është aplikuar në të gjitha dikasteret komunale.	Nuk është zbatuar.
15	Depozitimi i vonuar i parasë së arkëtuar	Kryetari duhet të forcojë kontrollet për të siguruar se depozitat e përditshme të parasë bëhen në fund të çdo ditë në përputhje me legjislacionin në fuqi.	Komuna kishte marrë masa në zbatimin e këtij rekomandimi.	Është zbatuar.
16	Rritja e të arkëtueshmeve	Kryetari duhet të siguroj që po shqyrtohen në mënyrë aktive të gjitha opsionet e mundshme, duke vendosur politika, rregullore dhe mekanizma tjerë me qëllim të rritjes së efikasitetit në mbledhjen e të arkëtueshmeve. Po ashtu duhet shqyrtuar të gjitha masat në pajtim me ligjin, ndaj operatorëve të cilët nuk i përmbushin obligimet kontraktuale.	Komuna edhe këtë vit vazhdon të ketë të njëjtën gjendje. Përpos vërejtjeve me shkrim dërguar palës masa të tjera të cilat janë paraparë gjatë përpilimit dhe nënshkrimit të kontratës nuk janë aplikuar.	Nuk është zbatuar.

17	Niveli i lartë i obligimeve dhe rritja e detyrimeve e kontingjente	Kryetari duhet të forcojë kontrollet në procesin e menaxhimit të pagesave për të siguruar që të gjitha faturat paguhen brenda afatit ligjor prej 30 ditëve pas pranimit të faturës. Po ashtu të sigurojë se raportimi i obligimeve bëhet për çdo muaj në përputhje me kërkesat ligjore e cila duhet të përfshijë gjendjen e saktë të tyre. Për detyrimet e viteve paraprake duhet të përcaktojë një plan shtesë për pagesën e tyre e cili duhet të përfundohet para përfundimit të vitit 2018.	Pagesat e vendimeve gjyqësore kanë ndikuar në zvogëlimin e obligimeve të paguara, por jo dhe aplikimi i ndonjë masë pro aktivë. Ndërsa niveli i rritjes së detyrimeve kontingjente edhe gjatë këtij viti është i shprehur.	Nuk është zbatuar.
18	Niveli i ulët i zbatimit të rekomandimeve nga viti paraprak dhe viti i mëhershëm	Kryetari duhet të sigurojë që zbatimi i planit të veprimit, monitorohet në vazhdimësi dhe raportohet në baza të rregullta mujore ose tre mujore në lidhje me progresin e arritur në këtë drejtim. Rekomandimet të cilat nuk zbatohen sipas afateve, të rishikohen në një afat të shkurtër nga kryetari, si dhe të ndërmerren veprime pro-aktive ndaj barrierave të paraqitura gjatë zbatimit.	Me gjithë hartimin e një plani të veprimit, një monitorim i tij edhe me teje është jo efektiv pasi edhe këtë vit komuna ka treguar dobësi në menaxhimin financiar, kontrolleve dhe raportimit.	Rekomandim i mbyllur.
19	Niveli i ulët i zbatimit të rekomandimeve të NJAB-së	Kryetari duhet marr të gjitha veprimet ndaj njësive administrative që u adresohen rekomandimet, që të kenë një përkushtim maksimal në marrjen e masave përmirësuese në fushat ku janë identifikuar dobësitë. Komiteti i Auditimit duhet t'i rishikoj rezultatet e auditimit të brendshëm dhe veprimet e ndërmarra nga menaxhmenti në lidhje me rekomandimet e auditimit të brendshëm.	Me gjithë funksionalizimin e komitetit të auditimit, gjithashtu dhe veprimet e marra edhe me tej shume nga rekomandimet e kësaj njësie nuk janë zbatuar.	Pjesërisht i zbatuar.
20	Dobësi në kontrollet menaxheriale dhe menaxhimin e rrezikut	Kryetari duhet të siguroj se është kryer një rishikim për të përcaktuar formën e raportimit financiar dhe operativ tek menaxhmenti i lartë, nga i cili mund të nxirren të gjitha informatat relevante që ndikojnë në vendimmarrjen cilësore dhe me kohë të menaxhmentit. Ecuritë buxhetore, duke përfshirë të hyrat dhe	Mos realizimi i buxhetit në nivel të kënaqshme nga disa kategori, mos hartimi i listës së rreziqeve, niveli i lartë i të arkëtueshmeve dhe obligimeve janë fakte se nuk	Nuk është zbatuar.

		shpenzimet, dhe plani i prokurimit duhet të jenë subjekt i raportimeve dhe rishikimeve të rregullta nga ana e menaxhmentit. Gjithashtu, për të reduktuar ndikimin e rreziqeve në nivele të pranueshme, organizata duhet të hartoj regjistrin e rreziqeve me të gjitha masat/veprimet e duhura për të vendosur nën kontroll kërcënimet e ekspozuara.	është përcaktuar dhe kryer një raportim i mirë	
Nr.	Fusha e auditimit	Rekomandimet e vitit 2018		
1	PFV	Kryetari duhet të sigurojë që është bërë një analizë për të përcaktuar arsyet për theksim të çështjes. Duhet të ndërmerren veprime për të adresuar dobësitë në regjistrimin dhe prezantimin e drejte të shpenzimeve dhe eliminuar dobësitë në shpalosjen e plot të pasurisë, obligimeve dhe llogarive të arkëtueshme të prezantuara si theksimi i çështjes te opinionimi i auditimit. Gjithashtu, kryetari duhet të sigurojë se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që plani i hartimit të PFV 2019 i adreson të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me pajtueshmërinë. Kjo gjithashtu duhet të përfshijë rishikimin e draft PFV-ve nga menaxhmenti, me fokus të veçantë në fushat me rrezik të lartë dhe/ose fushat ku janë identifikuar gabime në vitet e mëparshme. Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, nuk duhet të dorëzohet përveç nëse ndaj draft PFV-të janë aplikuar të gjitha kontrollet e nevojshme.		
2	Niveli i Realizimi Buxhetit	B1 Kryetari duhet të sigurojë që performanca buxhetore është monitoruar në mënyrë sistematike në baza mujore dhe që ky rishikim i identifikon dhe adreson barrierat për realizim të buxhetit në nivel të planifikuar. Aty ku supozimet e buxhetit fillestar janë të pasakta, kjo duhet të reflektohet plotësisht në pozitën e buxhetit final.		
3	Qarkullimi i mjeteve jo përmes LIVTH	Kryetari duhet të veproj, marr masa për të rregulluar menaxhimin financiar të bibliotekës duke futur në sistem këtë njësi. Pranimi i mjeteve publike duhet të depozitohen në llogarinë zyrtare bankare të përcaktuar nga Thesari dhe shpenzimi i këtyre mjeteve duhet të bëhet në përputhje me rregullat.		
4	Mos barazimi i të hyrave në mes drejtorive	Kryetari duhet të sigurojë se barazimet në mes të drejtorive përkatëse kryhen në baza të rregullta mujore dhe të gjitha mospërputhjet e mundshme të sqarohen me kohë.		
5	Mangësi në llogaritjen e bazës së tatimit në pronë	Kryetari duhet të sigurojë veprime shtesë si dhe të marrin veprim iniciues për përditësimin e rregullores në Asamblenë Komunale si dhe ndarjen e duhur të këtyre zonave tatimore me gjendjen faktike në teren.		
6	Dobësi në menaxhimin e	Kryetari duhet të shqyrtoj arsyet e gjendjes ekzistuese dhe të vendos masat e duhura që brenda një periudhe të arsyeshme të arkëtoj të gjitha borxhet e		

	kontratave me koncesion dhe qiradhënie	prapambetura, ose në të kundërtën, të ndaloj shfrytëzimin e pronave publike pronarëve, të cilët nuk i kanë kryer obligimet ndaj Komunes.
7	Faturimi jo i saktë i tatimi në pronë	Kryetari duhet të shqyrtoj arsyet e gjendjes ekzistuese dhe të vendos masat e duhura që brenda një periudhe të arsyeshme të arkëtoj të gjitha borxhet e prapambetura, ose në të kundërtën, të ndaloj shfrytëzimin e pronave publike pronarëve, të cilët nuk i kanë kryer obligimet ndaj Komunes.
8	Dobësi në menaxhimin e të hyrat nga sektori i mbeturinave	A4-Kryetari duhet të sigurojë se do të kryhen analiza të mirëfillta nga menaxhimi i mbeturinave në mënyrë që të arrihen objektivat e komunës në krijimin e sistemit të qëndrueshëm financiar. Po ashtu, të merret në konsideratë që paraprakisht të rifreskohet data baza e ngarkesave si dhe të bëhen ndryshimet dhe aprovimet në rregullore nga organi legjislativ për lirin apo përcaktimin e tarifa për amvisëritë e caktuara.
9	Shfrytëzimi i lokaleve afariste me çmim më të ulët	Kryetari duhet të sigurojë se personat përgjegjës respektojnë Rregulloren për dhënien në shfrytëzim të hapësirave publike përmes ankandit publik dhe kriteret e vendosura të bazohen në rregulla duke ofruar mundësin e përfitimeve maksimale nga procesi i ankandit.
10	Pagat dhe mëditjet-Mangësi në proces rekrutimit sipas ligjit të punës	Kryetari duhet të sigurojë se janë ndërmarrë veprime të menjëhershme për ta shqyrtuar këtë proces të punësimit, si dhe të sigurojë kontrolle efektive në mënyrë që proceset e rekrutimit të bëhen në përputhje të plotë me kërkesat e ligjit të punës.
11	Mangësi në procedura rekrutimi për shërbimin civil	Kryetari të siguroj që emërimet e kandidatëve bëhen vetëm pasi të jenë zbatuar të gjitha procedurat e rekrutimit dhe emërimit në përputhje me ligjet dhe rregulloret në fuqi.
12	Mungesë e dosjeve të personelit dhe pagesa pa bazë ligjore	Kryetari të siguroj rishikimin e mundësisë që këta zyrtarë të transferohen në institucionet ku ata punojnë, ose të kompletohen dosjet e tyre në komunë për të krijuar bazë ligjore për ekzekutimin e pagave të tyre. Pagesat e shtesave bëhen vetëm për zyrtarët që parashihen me vendimin e Qeverisë dhe shumat e përfituara në kundërshtim me këtë vendim të kthehen buxhetit të komunës.
13	Dosjet e personelit	Kryetari të sigurohet se drejtoret e institucioneve arsimore dhe menaxheri i personelit duhet të kompletojnë dëshmitë për përvojën e punës për të

	të pa azhurnuar	krijuar bazë ligjore për ekzekutimin e shtesës në bazë të përvojës. Po ashtu drejtoret e shkollave të monitorojë vlerësimet e performancës dhe dëshmitë e njëjta të vendosen në dosje të personelit.
14	Zyrtaret pa kontratë valide të punës	Kryetari i komunës duhet të siguroj se para skadimit të kontratave të punëtorëve të fillohet me procedurat e rekrutimit apo nëse paraqitet nevoja për vazhdimin e kontratave, procedurat e vazhdimit të jenë në përputhje me rregullat dhe udhëzimet në fuqi.
15	Kompensi min jo i rregullt i pushimit të lehonisë	Kryetari të sigurojë që personeli kompetent përcjell me kohë ndryshimet në listën e pagave dhe ndalesat e pushimit të lehonisë behën sipas rregullave dhe aplikohen në periudhën e duhur kohore.
16	Mallra dhe shërbime-Parregulls i në angazhimin e stafit për shërbime të veçanta	Kryetari duhet të sigurojë se marrëveshjet për shërbime të veçanta të planifikohen drejt dhe angazhimet për këto shërbime të mos zgjasin më shumë se gjashtë muaj. Po ashtu kryetari duhet të sigurojë se punonjësit me kontrata për shërbime të veçanta do të angazhohen vetëm në rastet kur ka kërkesa specifike.
17	Parregulls i e shpenzime për udhëtime zyrtare	Kryetari duhet të fillojë një shqyrtim gjithëpërfshirës si dhe financimi i udhëtimeve të personave jashtë komunës të bëhet vetëm në rastet kur pjesëmarrja e personave të tillë sjell përfitime direkt për komunën dhe në harmoni me legjislacionin në fuqi.
18	Investimet Kapitale-Dobësi sistematike në menaxhimin e pagesave dhe pranimin e punëve	Kryetari duhet të forcoj masat e kontrollit që dështimet e tilla të mos përsëriten. Duhet sigurohet se për mbikëqyrjen e projekteve janë vendosur zyrtar kompetent të cilët monitorojnë implementimin e kontratës dhe pranojnë vetëm punët e realizuar, nënshkruajnë situacionet sipas gjendjes faktike, në të kundërtën duhet të aplikohen masat për lëshimet e pa përgjegjshme apo neglizhente.
19	Prokurimet pa zotim të mjaftueshëm, zotimi pas pranimin të	Kryetari të siguroj që kontrollet janë funksionale dhe zyra e prokurimit nuk duhet të nënshkruaj asnjë kontratë publike pa zotim të mjeteve apo ndërmerr obligim në një shumë që i tejkalon fondet e ndara. Gjithashtu, duhet të sigurojë që hartimi i projekteve ekzekutive të realizohet në pajtim me kërkesat ligjore para inicimit të procedurave të prokurimit për punë, në të kundërtën nuk mund të fillon tenderimi i ekzekutimit të projekteve.

	faturave/ pranimit të mallit dhe mungesa e projekteve ekzekutiv	
20	Mungesa e dëshmime gjatë vlerësimit të kriterëve për dhënien e shtëpive për familjet skamnore	Kryetari i Komunës të siguroj kontrole të shtuara që gjatë vlerësimit të aplikacioneve për programet e veçanta të banimit, procesi i poentimit të kriterëve të vendosura duhet të mbështetet me dëshmi përkatëse.
21	Mos vazhdimi i sigurisë së ekzekutim it krahas periudhës së zbatimit të kontratës.	Kryetari të zhvillojë politika dhe procedura për t'u siguruar që realizimi i projekteve përmbushët brenda kornizës kohore të përcaktuar në kontratën përkatëse dhe të garantohen me sigurim të ekzekutimit gjatë tërë periudhës të përfundimit të punimeve në bazë të marrëveshjes kontraktuale, duke eliminuar edhe mundësin e kontraktimit pa fonde të mjaftueshme si dhe pengesat tjera gjatë ekzekutimit të punimeve.
22	Vonesat në ekzekutim in e kontratave	Kryetari të sigurojë kontrole më të fuqishme në mbikëqyrjen e realizimit të projekteve në mënyrë që ato të përfundohen sipas planit dinamik dhe pengesat si mungesa e mjeteve dhe problemet pronësorë janë eliminuar para hyrjes në kontratë. Aty ku vonesat janë rezultat i kontraktuesit të zbatohen masat ndëshkuese sipas kushteve të përcaktuara në kontratë, në mënyrë që të rritet përgjegjësia tek operatorët ekonomik.
23	Pagesat e gjobave si pasojë e vonesave në kryerjen e obligimeve	Kryetari i Komunës duhet të rrisë kontrollin në menaxhimin e projekteve. Fillimisht duhet të sigurohen fondet e nevojshme si dhe të gjitha parakushtet tjera për fillimin e projekteve, e më pas të zhvillohen procedurat tjera për kontraktimin me OE. Me tutje, të sigurojë kontrole në monitorimin e pagesave të faturave në afatin ligjor deri në procesin e ekzekutimit të pagesave.
24	Mos komunikimi dhe	Kryetari të siguroj që marrëveshjet e nënshkruara me donatorë dhe operator të zbatohet në tërësi dhe të mos ketë vonesa në kryerjen e obligimeve kontraktuale. Të vendosen kontrole që parandalojnë gabimet e tilla dhe të

	informimi me rastin e pagesave nga Thesari	sigurohet se për çdo gabim/lëshim nga organizatat varëse komuna e identifikon dhe reagon me kohë. Gjithashtu, të ndërmerren masa për vendosjen e komunikim me thesarin dhe informimin me kohë për pagesat që ekzekutohen nga thesari.
25	Pasuritë-Mangësi në inventarizimin dhe evidentimin e pasurisë dhe mungesë e procedurës së brendshme	Kryetari duhet të sigurojë se procesi gjithë përfshirës i regjistrimit të pasurive duhet të përfundoj me kohë dhe vazhdoj me vlerësimin e pasurisë brenda një afati optimal dhe pas përfundimit të procesit të përgatit një raport përfundimtar mbi gjendjen e pasurive, të cilin duhet ta harmonizoj me regjistrat kontabël të komunës. Diferencat e shfaqura duhet të sqarohen dhe regjistrat duhet të azhurnohen sipas të dhënave të regjistrimeve të fundit. Kërkesat në lidhje me regjistrimin dhe mirëmbajtjen e pasurive duhet të aplikohen në tërësi, përmes sistemit E- pasuria të evidentohen të gjitha hyrjet/daljet e pasurive të luajtshme (me vlera nën 1,000€) për të gjitha dikasteret komunale. Gjithashtu, duhet të siguroj hartimin e rregullave dhe procedurave të brendshme për evidencën, ruajtjen dhe tjetërsimin e pasurisë jo financiare sipas kërkesës së rregullore 02/2013.
26	Të arkëtueshme Nivelin e lartë të arkëtueshme	Kryetari duhet të siguroj që po shqyrtohen në mënyrë aktive të gjitha opsionet e mundshme, duke vendosur politika, rregullore dhe mekanizma tjerë me qëllim të rritjes së efikasitetit në mbledhjen e të arkëtueshmeve. Po ashtu duhet shqyrtuar të gjitha masat në pajtim me ligjin, ndaj operatorëve të cilët nuk i përmbushin obligimet kontraktuale.
27	Obligimet e paguara-Niveli i lartë i obligimeve	Kryetari duhet të forcojë kontrollet në procesin e menaxhimit të pagesave për të siguruar që komuna mos të hyjë në obligime pa fonde të mjaftueshme, që të gjitha faturat paguhen brenda afatit ligjor. Po ashtu të sigurojë se raportimi i obligimeve bëhet për çdo muaj në përputhje me kërkesat ligjore e cila duhet të përfshijë gjendjen e saktë të tyre.
28	Mos adresimi i rekomandimeve të NJAB	Për të arritur përfitimin maksimal nga shërbimet e auditimit të brendshëm, Kryetari duhet të sigurojë se do të plotësohet me personel të mjaftueshëm NJAB, si dhe të rishikojë arsyet për veprimet e limituara të ndërmarra në lidhje me rekomandimet. Gjithashtu, duhet të ndërmirën veprime shtesë për funksionalizimin e KA-të në mënyrë që të sigurojë mbikëqyrjen, ngritjen dhe fuqizimin e rolit të auditimit të brendshëm.
29	Dobësi në kontrollet menaxheriale dhe menaxhimin e rrezikut	Kryetari duhet të siguroj se është kryer një rishikim për të përcaktuar formën e raportimit financiar dhe operativ tek menaxhmenti i lartë, nga i cili mund të nxirren të gjitha informatat relevante që ndikojnë në vendimmarrjen cilësore dhe me kohë të menaxhmentit. Ecuritë buxhetore, duke përfshirë të hyrat dhe shpenzimet, dhe zbatimi i planit të prokurimit duhet të jenë subjekt i raportimeve dhe rishikimeve të rregullta nga ana e menaxhmentit.

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keq-deklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keqdeklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet të japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, përtëcilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragrafi të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

të përfshihet menjëherë pas opinionit;

të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;

të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe

të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca II: Letër e Konfirmimit

 Republika e Kosovës Republika Kosova Kosova Cumhuriyeti	 REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIK • KOSOVA CUMHURIYETI Komuna e Prizrenit • Opština • Prizren Belediyesi Kryetari i Komunës • Председател Општин • Belediye Başkanı	 Komuna e Prizrenit Opština Prizren Prizren Belediyesi
01 Nr. 64/19 Dt. 30.05.2019		

DATE:	
REFERENCE:	
PËR:	Zyrën Kombëtare të Auditimit
NGA:	Prof.dr. Mytaher Haskuka Kryetar i Komunës së Prizrenit
LËNDA/TEMA	LETËR E KONFIRMIMIT - Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm në Raportin e auditimit për vitin 2018 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Raportit/Pasqyrave Financiare të Komunës së Prizrenit, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

Prof. Dr. Mytaher Haskuka
Kryetar i Komunës,

Data: Maj, 2019, Prizren

